


UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI: MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

Studime postdiplomike -Master



TEZA MASTER

Përfshirja e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në tekstet shkollore të klasave VI, VII dhe VIII

Mentori:

Prof. Dr. Naser Zabeli

Kandidatja:

Erodita Pllana

Prishtinë, 2022

FAKULTETI I EDUKIMIT

Studimet Master

PROGRAMI: MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

TEZA MASTER

E paraqitur nga:

Erodita Pllana

Me kërkim të gradës shkencore

Master

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli

Tema: Përfshirja e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në tekstet shkollore të klasave VI, VII dhe VIII

Mbrohet para komisionit vlerësueses të përbërë nga:

Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli _____ mentor

Prof. Asoc. Dr. Begzad Baliu _____ kryetar

Prof. Ass. Dr. Arlinda Beka _____ anëtare

Prishtinë, Mars 2022

© [2022]-[Erodita Pllana] Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Abstrakt

Gjuha shqipe në përgjithësi e më shumë si lëndë në shkollë në veçanti, na përcjellë që nga fillimi i rrugëtimit tonë në rrugën e dijes e deri në nivelin më të lartë të shkollimit tonë .Rëndësia e saj shihet nga vendi që ajo zë si lëndë nëpër shkolla duke qenë edhe lënda bazë në të gjitha nivelet e arsimit.

Në këtë temë diplome do të përpiqemi të paraqesim përfshirjen e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës dhe vendin që ato zënë nëpër librat e gjuhës shqipe për klasat VI,VII dhe VIII.

Qëllimi i këtij punimi është të shohim se cilat pjesë të pandryshueshme të ligjëratës janë përfshirë në tekstet shkollore të klasave VI,VII dhe VIII dhe se a janë paraqitur mjaftueshëm në atë mënyrë që nxënësit të kenë informacione të bollshme nga kjo pjesë e gramatikës së gjuhës shqipe.

Objekt i këtij punimi do të jetë gramatika e gjuhës shqipe më saktësisht pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe përfshirja e tyre në libra shkollorë. Gjithashtu gjatë këtij punimi të diplomës do të jenë objekt hulumtimi mësimdhënësit dhe nxënësit e klasave të VI,VII dhe VIII -ta të disa prej shkollave të qytetit .Përmes këtij punimi do të arrihet të shihen se sa e rëndësishme është gramatika e gjuhës shqipe e në veçanti pjesët e pandryshueshme të ligjëratës për nxënësit e shkollës fillore.

Fjalët kyçe: *Gramatika, gjuha, nxënësit, pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.*

Abstract

The Albanian language in general and more as subject in particular, accompanies us from the beginning of our journey to the path of knowledge to the highest level of our education. Its importance is seen from the place it occupies as a subject in schools being also the core subject at all levels of education.

In this diploma we will try to present the immutable parts of the lecture and the place they occupy in the Albanian language books for grades VI, VII and VIII.

The purpose of this paper is to see which immutable parts of the lecture are included in the textbooks of grades VI, VII and VIII and whether they are presented enough so that students have ample information from this part of the grammar of the Albanian language.

The object of this paper will be the grammar of the Albanian language, more precisely the immutable parts of the lecture and their inclusion in textbooks. Also during this diploma thesis will be the object of research teacher and students of grades VI, VII and VIII of some of the schools in the city. Through this thesis will be achieved to see how important is the grammar of the Albanian language in particular the immutable parts of the lecture for elementary school students.

Keywords: *Grammar, language, students, immutable parts of speech.*

Falenderimi

Rruga drejt dijes është një rrugë shumë e vështirë por njëherit shumë e veçantë dhe një ndjenjë shumë e bukur. Nuk do të ishte një udhëtim i lehtë pa ndihmën dhe përkrahjen e njerëzve që të qëndrojnë gjithmonë pranë.

Dua ta falënderojë mentorin tim Prof, Dr. Naser Pajazitin që më ka ndihmuar dhe këshilluar në punimin e kësaj diplome.

Një falënderim shumë i madh dhe njëherit shumë i veçantë shkon për të gjithë familjen time që më kanë mbështetur gjithnjë pa asnjë kusht dhe pa të cilët nuk do të kisha mundur të arrijë deri këtu.

Falënderoj bashkëshortin tim dhe dy vajzat e mia që më kanë dhënë kurajo dhe inspirim që të arrijë deri këtu ku jam sot.

Gjithashtu një falënderim shkon edhe për shoqërinë time që nuk e kanë kursyer kohën e tyre për të më mbështetur gjithnjë.

Ju falënderoj përzemërsisht!

Përmbajtja

Abstrakt	i
Abstract	ii
Lista e tabelave	vi
Lista e figurave 1	vi
Lista e figurave 2	vii
Hyrje	1
Shqyrtimi i literaturës	2
I. KAPITULLI I PARË	5
1.1 Morfologjia – degë e gramatikës.....	5
1.2.Lidhjet e morfologjisë me disiplina të tjera të gramatikës	5
1.3.Pjesët e ligjëratës	6
1.4 Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës	7
1.4.1. Ndajfolja.....	7
1.4.2.Parafjalët	17
1.4.3. Lidhëzat.....	21
1.4.4 Pjesëzat.....	25
1.4.5.Pasthirma.....	28
II.KAPITULLI I DYTË	30
2.1. Plani dhe programi për lëndën e gjuhës shqipe për klasët 6,7 dhe 8	30
2.2. Fondi i orëve mësimore për lëndën e gjuhës shqipe për klasët 6,7dhe 8	30
2.3. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikën e klasës së 6	30
2.4. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikën e klasës së 7	34
2.5. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikën e klasës së 8	38
2.6. Didaktika e gjuhës shqipe	40
2.7.Metodologjia e gjuhës shqipe.....	41

III.KAPITULLI I TRETË	43
3.Formulimi i problemit	43
3.1.Qëllimi i hulumtimit.....	43
3.2.Rëndësia e studimit	44
3.3.Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza.....	44
3.4 Metoda e hulumtimit, popullacioni dhe kampioni	45
3.5.Popullacioni.....	46
3.6 .Pyetësorët	46
3.8.Analiza	46
3.9.Rezultatet e pritura	47
IV. ANALIZA E REZULTATEVE	48
4.1 Analiza e rezultateve për pyetësorët e realizuar me mësimdhënës	48
4.2 Analiza e rezultateve për pyetësorët e realizuar me nxënës.....	54
V. KONKLUKIME DHE REKOMANDIME	60
VI.LITERATURA.....	62
SHTOJCA A.....	64
SHTOJCA B.....	66

Lista e tabelave

Tabela 1. Paraqitja e përgjigjeve në formë tabelare sipas pyetjeve të pyetësorit për mësimdhënës	48
Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas shkollave në hulumtimin e kryer me mësimdhënës	48
Tabela 3. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë në hulumtimin e kryer me mësimdhënës.....	48
Tabela 4. Paraqitja e përgjigjeve në formë tabelare sipas pyetjeve të pyetësorit për nxënës.....	54
Tabela 5. Shpërndarja e mostrës sipas shkollave në hulumtimin e kryer me.....	54
Tabela 6. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë në hulumtimin e kryer me nxënës	54

Lista diagrameve

Diagrami 1. A e dini se cilat janë pjesët e ligjëratës?.....	55
Diagrami 2. Po pjesët e pandryshueshme të ligjëratës?	55
Diagrami 3. A keni vështirësi në kuptimin e tyre gjatë shpjegimit	56
Diagrami 4. A janë dhënë përkufizime dhe shembuj të mjaftueshëm për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës në librat që ju i mësoni?	56
Diagrami 5. A mendoni që përmbajtjet në gramatikat ekzistuese duhet të ndryshojnë?.....	58
Diagrami 6. A mendoni që duhet të shtohet ndonjë njësi më shumë për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës?.....	58
Diagrami 7. A mendoni që mësimi për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës i përshtatet nivelit tuaj?.....	58
Diagrami 8. A mund të mësoni në mënyrë të pavarur me informacionet që gjenden në libër?. 58	
Diagrami 9. A lexoni libra shtesë për të kuptuar më mirë për njësitë që lidhen me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës?	59
Diagrami 10. Rrumbullakëso njëri nga teknikat mësimore që përdor arsimtari për zhvillimin e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës si të mësimore?.....	559

Lista e grafikoneve

Grafikoni 1. Sa janë të përfshira pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatika për klasën e 6, 7 dhe 8?.....	49
Grafikoni 2. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës më shumë përfshihen.....	49
Grafikoni 3. Librat e gramatikës që përdoren në klasat 6,7 dhe 8 a janë të përshtatshme për nxënës?	50
Grafikoni 4. Përkufizimet, shembujt për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës a janë përfshirë mjaftueshëm në gramatika të gjuhës shqipe?	50
Grafikoni 5. A mendoni që mësimi për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës i përshtatet nivelit të nxënësve	51
Grafikoni 6. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikat 6,7 dhe 8-të a përshtatet për mësim të pavarur nga nxënësit?.....	51
Grafikoni 7. A kanë vështirësi nxënësit gjatë përdorimit të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës gjatë detyrave në klasë?	52
Grafikoni 8. Nxënësit kanë vështirësi të dallojnë:	52
Grafikoni 9. A u jepni nxënësve informacione shtesë në lidhje me njësinë mësimore që e zhvillon?.....	53
Grafikoni 10. Rrumbullakëso njëri nga teknikat mësimore që përdor më shumë gjatë shpjegimit të njësive mësimore	53

Hyrje

Gjuha shqipe, krahas vlerave të shumta edukative që përcjellë në vete, është një monument i madh, një visar i mrekullueshëm i bukurisë e thjeshtësisë së fjalës shqipe. Siç dihet, gjuha dhe letërsia shqipe zënë një vend me rëndësi në planprogramet e shkollës sonë. Si lëndë e veçantë ajo mësohet që nga klasa e parë e shkollës fillore e deri në klasat e fundit të arsimit të mesëm, si dhe në shumë shkolla të larta e fakultete, që përgatisin kuadro të profilit arsimor.

Në këtë punim do të përqipemi të sjellim një pjesë të gramatikës së gjuhës shqipe gjegjësisht morfologjisë dhe do të flasim për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.

Në pjesën e parë të punimit do të flasim pak për degën e gramatikës, morfologjinë ,duke vazhduar më pas me pjesët e pandryshueshme të ligjëratës duke shpjeguar me radhë ndajfoljen, pjesëzën pasthirmën, lidhëzën dhe parafjalën.

Në pjesën e dytë do të mundohemi të shohim se cilat pjesë të pandryshueshme të ligjëratës janë përfshirë në gramatikat e gjuhës shqipe për klasa të gjashta ,të shtata dhe të teta, dhe se a janë paraqitur mjaftueshëm .Do të shohim se a janë dhënë informacione të mjaftueshme për ta në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i dallojnë ato nëpër tekste të ndryshme si në shkollë ashtu edhe jashtë saj.

Pjesa e tretë e këtij punimi do t'i kushtohet hulumtimit të bërë në shkolla fillore përmes një pyetësori për nxënës dhe mësime dhënë duke u munduar që të sjellim rezultate sa më të sakta në mënyrë që ky punim të jetë sa më i plotë.

Pjesa e katërt e punimit do të jetë me analizën e rezultateve nga pyetësorët e realizuar me mësime dhënë dhe nxënës të shkollave të mesme të ulëta.

Nga ky punim diplome do të përqipemi të nxjerrim rezultate të mjaftueshme për sa i përket përfshirjes së pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, dhe mënyrës se si ato u janë dhënë nxënësve me qëllim të fitimit të një kulture të përgjithshme të nxënësit e në veçanti të kulturës nga gjuha shqipe. Në kuadër të këtij hulumtimi, është e rëndësishme të theksohet se kjo pjesë e gramatikës zë një vend të veçantë dhe njëherit shumë të rëndësishme dhe duhet të shihet sa a është dhënë mjaftueshëm në mënyrë që nxënësit të formësojnë të kuptuarit për gramatikën e gjuhës shqipe.

Shqyrtimi i literaturës

Sipas Gjokutaj (2012) mësimi i gjuhës amtare në shkollë ,në kuadrin e mësimimit të gjuhëve moderne, zë vendin më të rëndësishëm në tërë strukturën dhe përmbajtjen e planeve të programeve shkollore. Nga kjo pamë se sa e rëndësishme është gjuha shqipe dhe se çfarë vendi zë ajo nëpër shkolla Pasi që tema e këtij punimi është nga Gramatika e gjuhës shqipe është hulumtuar vetëm pjesa ku janë të përfshira pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, prandaj tekstet shkollore janë shfrytëzuar si literaturë bazë dhe njëherit si literaturë studimi.

Më e rëndësishmja është literatura bazë, pra tekstet shkollore që do të studiohen: Gjuha shqipe 6 ,Gjuha shqipe 7 dhe Gjuha shqipe 8. Rugova (2019) thekson se teksti synon të përmbushë objektivin themelor në arsimin e detyruar në Kosovë që është mësimi i gjuhës dhe i shkathtësive komunikuese. Sipas Gjokutaj (2012) gjuha që mësojnë dhe fitojnë nxënësit në shkollë, është pasqyrë e formimit si individ dhe karakterisitkë e të folurit të tyre. Për gjuhën shqipe, historinë e saj, për ndarjen e saj ka shkrime të ndryshme dhe kritika të shumta nga studiues të shumtë. Si ndihmë për hartimin e këtij punimi na kanë ardhur po këto studime dhe kritika të autorëve të ndryshëm shqiptar. Meqë kemi temën nga gramatika e gjuhës shqipe gjegjësisht nga morfologjia si një ndarje e gramatikës së gjuhës shqipe po ndajmë disa mendime të dhëna për të. Morfologjia si degë e gramatikës studion pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës. Morfologjia nuk merret me studimin e fjalëve të veçanta. Ajo studion veçoritë e përbashkëta të fjalëve të së njëjtës klasë, duke nxjerrë kështu rregulla me karakter të përgjithshëm, që kanë vlerë për mbarë klasën e dhënë, e si rrjedhim, edhe për secilën nga fjalët e asaj klase.(*Agalliu,Angoni, Demiraj, Dhrimo, Hysa, Lafe & Likaj, 2002,f.29-30*).

Sipas Agaliut, Santorit, Demiraj, Dhrimaj, Hysa, Lafe & Likaj (2002), Morfologjia (nga greqishtja morfe-formë dhe logos-fjalë, dije)është ajo pjesë e gramatikës, që merret në rradhë të parë me studimin e trajtëformimit,d.m.th me studimin e formave të ndryshme, që marrin fjalët e lakueshme (emrat, mbiemrat, përemrat dhe numërorët ose të zgjedhueshme (foljet), dhe të palakueshme ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirmat) si dhe me studimin e kuptimeve të këtyre formave. Por, në një vështrim më të gjerë morfologjia merret me klasifikimin e fjalëve në kategori leksiko-gramatikore, që quhen pjesë të ligjëratës. Edhe Jashari dhe Çitaku (2012) thanë që morfologjia studion, format e ndryshme që marrin fjalët gjatë përdorimit dhe kuptimet e këtyre formave, klasifikimin e fjalëve në kategori leksiko-

gramatikore, ose klasa fjalësh që quhen tradicionalisht pjesë të ligjëratës. Pasi që morfologjia meret me pjesë të ligjëratës, edhe për këtë pjesë të rëndësishme kanë shkruar mjaftë kritikë të ndryshëm. Sipas Paqarizit & Selmanit (2019) fjalët e ndryshme të një gjuhe ndahen në pjesë të ligjëratës. Grupimi nëpër pjesë të ligjëratës bëhet në bazë të ngjashmërisë së funksioneve. Pra, funksioni që fjala kryen në një fjali e përcakton përkatësinë e saj në pjesë të ligjëratës, ndonëse edhe për nga forma mund ta identifikojmë përkatësinë e një fjale në një pjesë të caktuar të ligjëratës. Në bazë të veçorive morfologjike pjesët e ligjëratës ndahen në: **Pjesë të ndryshueshme të ligjëratës** janë fjalët që lakohen: (emri, përemri, mbiemri, numërori, folja) **Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës** janë fjalët që as nuk lakohen dhe as nuk zgjedhohen (ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza dhe pasthirma). Pasi që tema për këtë punim është përfshirja e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës medoemos që në pjesë të parë kemi folur për të gjitha pjesët e pandryshueshme të ligjëratës duke shfrytëzuar mendime dhe kritika të ndryshme sa i përket të gjitha pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës. “Ndajfolja është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që emërton një tipar të veprimit apo të gjendjes, në të cilat kryhet ky veprim ose tregon shkallën e një cilësie, të një rrethane ose intensitetin e veprimit. *Jashari&Çitaku,2012,f.108*). Ndërsa sipas Becit (2002) ndajfolje janë fjalët e pandryshueshme që plotësojnë para së gjithash foljen duke treguar mënyrë, vend, kohë, sasi. Ato kanë kuptim të mëvetësishëm leksikor dhe në fjali ato përdoren si gjymtyrë të veçanta.

Libri “Gjuha shqipe 6” i hartuar nga Rugova, Elezi, Jakupi dhe Baftiu tekst ky që mësohet nga nxënësit e klasës së gjashtë të shkollave të mesme të ulëta ka gjithsej 37 njësi ,prej tyre për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës janë 3 njësi: ndajfolja, parafjala dhe lidhëza.

Në gramatikën e klasës së shtatë të autorëve: Rrahman Paqarizi dhe Adelina Selmani dhe me gjithsej 35 njësi , për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës janë dy njësi të njëjta që përsëriten prej klasës së gjashtë :kemi të bëjmë përsëri më ndajfoljen dhe me lidhëzat.

Libri i gjuhës shqipe për klasën e tetë me autor Bahri Becin, është i ndarë në katër kapituj, me gjithsej 41 mësim ose seanca mësimore. Në këtë tekst në lidhje me temën tonë, pra për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës kemi të bëjmë me pjesëzat dhe vlen të përmendet që edhe drejtshkrimi i gjuhës shqipe është shumë i rëndësishëm ndaj sipas Akademia e Shkencave e R. të Shqipërisë (1973) Drejtshkrimi i njësuar i shqipes mbështetet gjerësisht edhe në parimin morfologjik i cili kërkon që fjalët dhe pjesët e tyre përbërëse të sistemit trajtëformues e

fjalëformues të shkruhen njësoj, pavarësisht nga ndryshimet tingëllore të shkaktuara prej ligjeve fonetike që veprojnë sot në gjuhën tonë. Ndërsa Memushaj (2004) thekson se shprehitë e të shkruarit pa gabime formohen në mënyrë pothuajse të pavetëdijshme në një moshë relativisht të vogël, që përkon në ciklin e ulët të tetëvjeçares. Formimi i këtyre shprehive varet në një masë të madhe nga aftësia e fëmijëve të kësaj moshe për ta “fotografuar” fjalën dhe për t’i ruajtur në kujtesë format e saj.

I. KAPITULLI I PARË

Arsimi konsiderohet proces sistematik dhe pedagogjik përmes së cilit individët e rinj pajisen me njohuri, shprehje dhe shkathtësi për jetë dhe punë (Brada, 2011). Gjuha shqipe si lënda kryesore në shkolla është thelbësore për nxënësit që të arrijnë rezultate në tërë shkollimin që i përcjellë gjatë gjithë jetës së tyre. Sipas Gjokutaj (2012) nëpërmjet mësimin të gjuhës shqipe hidhen bazat për zhvillimin intelektual, emocional e shoqëror të nxënësit, duke mundësuar realizimin e komunikimit për qëllime të ndryshme; duke zbuluar përvojat, ndjenjat dhe idetë e tyre dhe të tjerëve; duke i dhënë kuptim të menduarit.

1.1 Morfologjia – degë e gramatikës

Morfologjia (nga greq. *morphe*-formë dhe *logos*-fjalë, dije, teori) studion:

1. Format e ndryshme që marin fjalët gjatë përdorimit dhe kuptimet e këtyre formave.
2. Klasifikimin e fjalëve në kategori leksiko-gramatikore, ose klasa fjalësh që quhen tradicionalisht **pjesë të ligjëratës**:
3. Strukturën morfologjike të fjalëve-morfemat dhe llojet e tyre dhe
4. Tipet kryesore të fjalëformimit .(*Jashari&Çitaku,2012,f.4*).

Morfologjia nuk merret me studimin e fjalëve të veçanta. Ajo studion veçoritë e përbashkëta të fjalëve të së njëjtës klasë, duke nxjerrë kështu rregulla me karakter të përgjithshëm, që kanë vlerë për mbarë klasën e dhënë, e si rrjedhim, edhe për secilën nga fjalët e asaj klase.(*Agalliu, Angoni, Demiraj, Dhrimo, Hysa, Lafe & Likaj, 2002,f.29-30*).

1.2.Lidhjet e morfologjisë me disiplina të tjera të gramatikës

Morfologjia lidhet ngushtë me sintaksën dhe të dyja bashkë konsiderohen si dy pjesë të gramatikës. Është e rëndësishme të dihet që nuk mund të studiohen format gramatikore të fjalës në morfologji pa pasur parasysh edhe funksionet e tyre sintaksore. Por, me gjithë lidhjet e ngushta ndërmjet tyre, morfologjia dhe sintaksa janë dy pjesë të ndryshme të gramatikës, që kanë secila objektin e vet të studimit. Ndërsa morfologjia merret kryesisht me pjesët përbërëse të fjalës, sintaksa merret kryesisht me bashkimin e fjalëve në togje dhe në togfjalësha dhe me bashkimin e fjalëve, të togjeve e të togfjalëshave në fjali. Morfologjia ka lidhje të ngushtë edhe me fonetikën sepse shumë dukuri fonetike kanë funksione gramatikore të caktuara.

1.3.Pjesët e ligjëratës

Të gjitha fjalët e gjuhës, sipas veçorive të përbashkëta leksikore dhe gramatikore ,grupohen në klasa a kategori leksiko-gramatikore, që quhet **pjesë të ligjëratës** (Jashari&Çitaku,2012,f.4).

Në gjuhën shqipe dallohen qartë këto pjesë të ligjëratës:

1.Emri; 2.Mbiemri; 3.Numërori; 4.Përemri; 5.Folja; 6.Parafjala; 7.Ndajfolja; 8.Lidhëza; 9.Pjesëza; 10.Pasthirma.

Në bazë të veçorive kuptimore pjesët e ligjëratës ndahen në tri:

1.Fjalë kuptimplota – kanë kuptim leksikor të plotë që i lejon të përdoren si gjymtyrë më vete. Këtu hynë:

- a) **Fjalët emërtuese (emrat, mbiemrat, foljet, ndajfoljet)**
- b) **Fjalët numëruese (numërorët)**
- c) **Fjalët treguese (përemrat)**

2. Fjalë jokuptimplota- janë ato që kanë një kuptim leksikor të kushtëzuar nga roli që kryejnë në fjali. Këtu hynë : **parafjalët, lidhëzat dhe pjesëzat.**

3.Fjalët thirmore. Janë ato që shprehin, në formë thirjesh, ndjenja të folësit. Këtu hynë **pasthirmat.**

Në bazë të veçorive morfologjike pjesët e ligjëratës ndahen në :

1. **Pjesë të ndryshueshme të ligjëratës** janë fjalët që lakohen: (emri, përemri, mbiemri, numërori, folja)
2. **Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës** janë fjalët që as nuk lakohen dhe as nuk zgjedhohen (ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza, pasthirma).

Së fundi në bazë të kriterit sintaksor të aftësisë ose paaftësisë për t'u përdorur si gjymtyrë në vete në fjali, pjesët e ligjëratës ndahen në :

1. **Fjalë të mëvetësishme (emri, folja, mbiemri, numërorët, përemri, ndajfolja)**
2. **Fjalë të pamëvetësishme (parafjala, lidhëza, pjesëza)**

1.4 Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës

1.4.1. Ndajfolja

Ndajfolja është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që emërton një tipar të veprimit apo të gjendjes, në të cilat kryhet ky veprim ose tregon shkallën e një cilësie, të një rrethane ose intensitetin e veprimit. Ndajfoljet rregullisht plotësojnë kuptimin e një foljeje, të një mbiemri prejfoljor dhe të një ndajfoljeje tjetër. Më rrallë plotësojnë një emër, kryesisht prejfoljor, por edhe jo prejfoljor P.sh.: *Sokoli këndonte bukur. Ai flet shumë rrallë. Të ngriturit shpejt është i këshillueshëm. Dhoma sipër është e madhe. (Jashari&Çitaku,2012,f.108).* Ndajfolje janë fjalët e pandryshueshme që plotësojnë para së gjithash foljen duke treguar mënyrë, vend, kohë, sasi. (Beci,2002,f.104). Ato kanë kuptim të mëvetësishëm leksikor dhe në fjali ato përdoren si gjymtyrë të veçanta. Është e rëndësishme që të dihet se ndajfolja nuk ka asnjë kategori gramatikore përveç kategorisë së shkallës.

Klasifikimi i ndajfoljeve

Sipas kuptimit ndajfoljet klasifikohen në:

1. **Ndajfolje përcaktore** –janë dy lloje (**ndajfolje mënyre dhe sasi**)
2. **Ndajfolje rrethanore** - janë tri lloje (**ndajfolje kohe, ndajfolje vendi dhe ndajfolje shkaku**).

1.Ndajfolje përcaktore- Ndajfoljet përcaktore siç tregon edhe vetë shprehja emërtojnë tiparin e veprimit të shprehur nga folja. Siç e përmendëm më lartë ndajfoljet përcaktore janë dy llojesh:

a) ndajfolje mënyre

b) ndajfolje shkaku.

a) **Ndajfoljet e mënyrës** tregojnë tiparin e veprimit. Këtu përfshihen ndajfoljet që nga ana kuptimore janë të ndryshme, konkretisht:

- ndajfolje mënyre që përcaktojnë gjendjen shpirtërore a fizike të atij që kryen veprimin :*gëzueshëm, hareshëm, natyrshëm, fuqishëm, mendushëm etj.*

P.sh: *Shiu godiste fuqishëm.*

-ndajfolje mënyre që tregojnë përmasa: **cekët, gjerë, gjatë, thellë, ulët etj.**

P.sh: **Cekët, e mori lumi.**

-ndajfolje që përcaktojnë ecurinë e procesit të veprimit.: **menjëherë, pak nga pak, papritur, shpesh etj.** P.sh.*Shiu nisi papritur e papandehur.*

-ndajfoljet e formuara me prapashtesën-(i) sht që kanë kuptime të veçanta: **artistikisht, besnikërisht, teorikisht, bujarisht etj.**p.sh: *Shqiptari e pret mikun bujarisht.*

-ndajfolje mënyre meren edhe fjalët që tregojnë se në ç'gjuhë flasin popujt: p.sh **shqip, frëngjisht, italisht etj.**

Ndajfoljet e sasisë përcaktojnë kryesisht foljet duke treguar intensitetin apo shkallën e veprimit. : **fort, fort e më fort, tepër, shumë etj.** p.sh: *Librin ri e lexova shumë shpejt.*

2.Ndajfolje rrethanore Ndajfoljet rrethanore emërtojnë rrethanat në të cilat kryhet veprimi i shprehur nga folja. Këto janë tri llojesh:

- a) Ndajfolje kohe
- b) Ndajfolje vendi
- c) Ndajfolje shkaku(*Jashari&Kryeziu,2011,f.261*).

a) Ndajfoljet e kohës emërtojnë një rrethanë kohe, tregojnë kohën kur kryhet veprimi apo gjendja e treguar nga folja. Ndajfoljet e kohës mund të tregojnë:

- kohën e saktë të kryerjes së një veprimi: **dje, nesër, pardje, pasdreke, sonte.**
-disa ndajfolje që kanë kuptime të papërcaktuara: **dikur, njëherë, një ditë, së shpejti etj**
zgjatjen e një veprimi a të një gjendje ose të një veprimi pas një periudhe të caktuar kohe: **gjatë, gjithmonë, kurdoherë, javë për javë, kohë pas kohe etj .**

b) Ndajfoljet e vendit: Ndajfoljet e vendit mund të tregojnë vendin ku kryhet një veprim apo ndodh një ngjarje, duke pasur pikë orientuese. (*Jashari&Kryeziu,2011,f.263.*).

Ato tregojnë:

-vandin ku kryhet një veprim a ndodh një ngjarje. Ndajfoljet e vendit mund të tregojnë vendin ku kryhet një veprim apo ndodh një ngjarje, duke pasur pikë orientuese. Të tilla janë: *afër, aty, atje, djathtas, këtu, larg, matanë, përtej, pranë* etj.

- disa ndajfolje e lokucione ndajfoljore mund të tregojnë vendin e kryerjes së veprimit në një mënyrë pak a shumë të papërcaktuar. Të tilla janë: *diku, gjëkund, gjithkund, gjetiu, vendevende*.

- si ndajfolje vendi merren edhe ndajfoljet pyetëse *ku, nga*, ku përdoren në fjali pyetëse të drejta e të zhdrejta :p.sh: *Ku do të shkosh? Nga ikën shokët? Nuk e dinte nga i vinte gjithë ky gëzim.* (Jashari&Çitaku,2012,f.110).

Në këtë grup mund të përfshihen edhe ndajfoljet: *anëmbanë, anekënd, gjithandej, kudo, ngado, tekdo* etj. Ashtu si te ndajfoljet e kohës, edhe te ndajfoljet e vendit ka disa fjalë, si: *asgjëkund, askundi, gjëkund, kund, kurrkund*, që përdoren nëpër fjali mohuese, si pjesë e dytë përforcuese.

c) **Ndajfoljet e shkakut** –shërbejnë për të pyetur për shkakun ose qëllimin e kryerjes së një veprimi. . Ato janë *pse e përse*. P.sh.: *Pse pushoi muzika? Ja përse shkolla duhet të bëhet një vatër e madhe mësimi dhe edukimi.*

Në ndajfoljet e shkakut vend të veçantë zënë fjalët **prandaj, andaj**, që janë të barazvlefshme me togon **për këtë shkak, për këtë qëllim**.

Shkallët e ndajfoljeve

Ashtu si mbiemrat, edhe ndajfoljet kanë një veçori gramatikore, që nuk e kanë pjesët e tjera të ligjëratës: aftësinë për t'u përdorur në shkallë të ndryshme. Këtë aftësi e kanë, në radhë të parë, ndajfoljet përcaktore e brenda tyre, kryesisht ndajfoljet e mënyrës që afrojnë me mbiemrat. Po edhe ndajfoljet rrethore, sidomos ato që shprehin rrethana vendore, përdoren në shkallë të ndryshme krahasimi (*mirë, më mirë, shumë mirë, larg, më larg, shumë larg*(Jashari & Çitaku 2012,f.110).

Ndajfoljet mund të përdoren në shkallë të ndryshme. Kemi gjithsej tri shkallë kryesore dhe ato janë:

1. **Shkalla pohore**
2. **Shkalla krahasore**
3. **Shkalla krahasore ndahet në (shkallë krahasore të barazisë dhe shkallë krahasore të pabarazisë)**
Shkalla sipërore

a) **Shkalla pohore** është shkalla bazë mbi të cilën mbështeten shkallët tjera.

b) Shkalla krahasore

Shkalla krahasore ka në bazë gjithmonë një krahasim. Ndajfolja në shkallën krahasore tregon se gjymtyra e dytë e krahasimit është në një shkallë më të lartë apo më të ulët se gjymtyra e dytë, ose është në të njëjtën shkallë me këtë gjymtyrë.

Shkalla krahasore ndahet në **shkallën krahasore të barazisë** dhe **shkallën krahasore të pabarazisë**. Shkalla krahasore e pabarazisë ndahet në **shkallën krahasore të sipërisë** dhe në **shkallën krahasore të ultësisë**.

Ndajfolja në shkallën krahasore të barazisë tregon se gjymtyra e parë e krahasimit është në të njëjtën shkallë me gjymtyrën e dytë, P.sh.: *Atë ditë recitoi **aq** bukur **sa** herët e tjera.*

- Shkalla krahasore e sipërisë

Ndajfolja në këtë shkallë tregon se gjymtyra e parë e krahasimit është në një shkallë më të lartë se gjymtyra e dytë. Gjymtyra e dytë ndërtohet me lidhëzat **se** ose **nga**, por mund të jetë edhe pjesë e nënrenditur krahasore. P.sh.: *Pagjumësia e vriste ndoshta më keq se uria. Dimri erdhi më vonë, po më rreptë nga ç' pritej.*

Ndajfolja në këtë shkallë mund të paraprihet nga ndajfoljet **shumë** dhe **pak** për të treguar se gjymtyra e parë e krahasimit është më lart se e dyta në masa të ndryshme, p.sh.: *Besimi në aftësitë e të birit iu rrit edhe më tepër.* Për të treguar rritje përpjesëtimore të shkallës në të dyja gjymtyrët e krahasuara, ndajfolja në shkallën krahasore të sipërisë shoqërohet me lidhëzën **sa**, e cila lidhet me gjymtyrën e dytë me ndajfoljet **aq**, **kaq**, P.sh.: *Sa më afër vinte, **aq** më qartë i dukej e qeshura e ëmbël në buzë.*

- Shkalla krahasore e ultësisë

Në këtë shkallë ndajfolja tregon se gjymtyra e parë e krahasimit qëndron në një shkallë më të ulët se gjymtyra e dytë. Gjuha standarde më shpesh e jep idenë e shkallës krahasore të ultësisë me mohimin e shkallës krahasore të barazisë përmes shprehjeve **jo aq...sa** ose **nuk(s')** + **folje +aq + ndajfolje**, p.sh.: *Tani lexonte jo aq shumë sa dikur. I biri nuk i merrte më punët aq rrëmbyer.*

c) Shkalla sipërore

Në këtë shkallë ndajfolja tregon se cilësia apo intensiteti i veprimit është në një shkallë shumë të lartë, vështruar jashtë çdo krahasimi. Ndërtohet në mënyrë analitike me anë të ndajfoljeve **shumë, mjaft, fare, tepër, krejt, fort, jashtëzakonisht**. P.sh.: *Tani nxënësit përgatiten shumë (jashtëzakonisht) mirë. Fantazia shkonte tepër larg.*

Formimi i ndajfoljeve

Sa i përket formimit të ndajfoljeve ato mund të jenë **fjalë të parme dhe jo të parme** (pra ndajfolje të formuara me prejardhje, përngjitje, konversion ose lokucione.)

1. Ndajfolje të parme janë ato ndajfolje që nuk formohen prej asnjë pjesë tjetër të ligjëratës. Të këtilla janë: **afër, larg, atje, aty, kështu, pas, poshtë, prapa etj.**

2. Ndajfolje jo të parme

Lokucione ndajfoljore

Me lokucion ndajfoljor kuptohet një grup fjalësh që kanë lidhje të qëndrueshme midis tyre dhe që, si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht janë të barasvlershme, por jo të njëjta, me një ndajfolje. Pra, lokucioni ndajfoljor, si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht, zë një pozitë të ndërmjetme midis togut apo togfjalëshit të lirë dhe fjalës (në këtë rast ndajfoljes), por duke qëndruar më afër kësaj të fundit. Me kalimin e kohës lokucionet ndajfoljore përfundojnë në fjalë të përngjitura. Në gjuhën shqipe ka mjaft lokucione ndajfoljore, që nga ana e strukturës janë të

ndryshme. Një numër jo i vogël lokucionesh ndajfoljore janë të formuar me përsëritje të tipave të ndryshëm. Kemi kështu:

a) Lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër të lidhur me lidhëzën *e* po
b) ka dhe lokucione ndajfoljore të formuara nga bashkimi i dy emrave me kuptim pak a shumë të afërt, sinonimik, ose edhe me kuptim antonimik, nëpërmjet **lidhëzës e**, më rrallë dhe pandërmjetësinë e saj. Të tilla janë lokucionet: *anës e anës, çift e çift, palë e palë, rreth e rreth, varg e varg, copë e çikë, ditë e natë, natë e ditë, fund e krye, hundë e buzë, lesh e li, orë e çast, pikë e vrer, tym e flakë, varg e vistër, dimër e verë, verë e dimër, natë e ditë, ditë e natë*.

c) Lokucionet ndajfoljore formohen edhe nga bashkimi i ndajfoljeve me kuptim antonimik, të lidhura ose jo me lidhëzën këpujore *e*, P.sh.: *andej-këtej, tutje-tëhu,*

aty- këtu, poshtë e lart e lart e poshtë ose edhe me përsëritjen e së njëjtës ndajfolje me lidhëzën *e* :*shpejt e shpejt, pranë e pranë, mirë e mirë*.

d) Me lokucionet ndajfoljore lidhen për nga origjina edhe njësitë e formuara nga përsëritja drejtpërdrejtë e një emri në formën e numrit shumës.P.sh.: *copa-copa, copë-copë, dallgë-dallgë, fije-fije, flokë-flokë, gropa-gropa, grupe-grupe, shkallë-shkallë, valë-valë, vendevende*.

Nga ana kuptimore përsëritjet e këtij tipi tregojnë kryesisht mënyrën e kryerjes së një veprimi, më rrallë tregojnë rrethana kohe dhe vendi. Në kontekste të veçanta përsëritjet e këtij tipi funksionojnë edhe si mbiemra.

e) Lokucionet ndajfoljore mund të formohen edhe nga përsëritja e së njëjtës ndajfolje pa lidhëzën *e*, si *hollë-hollë, rëndë-rëndë, shumë-shumë*.

f) Me tipin e mësipërm lidhen dhe njësitë e formuara nga përsëritjet në trajta të ndryshme të tipit *emër në emëroren e shquar njëjës + emër në dhanore të shquar*. Të këtij tipi janë: *dita-ditës, dora-dorës, gryka-grykës, gjurma-gjurmës, hera-herës, këmba-këmbës, nata-natës*.

g) Lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e njëjtit emër me ndërmjetësinë e parafjalëve të ndryshme.

h) Nga përsëritja e një emri me ndërmjetësinë e parafjalës **për**:

- për të treguar kohën e kryerjes së një veprimi të përsëritur: *darkë për darkë, ditë për ditë, drekë për drekë, javë për javë, mbrëmje për mbrëmje, mëngjes për mëngjes, mot për mot, natë për natë, orë për orë, vit për vit etj.;*

- për të treguar mënyrën e kryerjes së një veprimi: *ballë për ballë, dorë për dorë, dhëmb për dhëmb, fjalë për fjalë, flakë për flakë, fyt për fyt, grykë për grykë, krah për krah* etj.

Siç shihet, në të gjitha rastet emri i përsëritur me parafjalën *për* është gjithnjë në rasën kallëzore të pashquar;

i) Nga përsëritja e një emri me ndërmjetësinë e parafjalës *më*:

- për të treguar vendin e kryerjes së një veprimi: *breg më breg, degë më degë, rrugë më rrugë, skaj më skaj, shpat më shpat, shteg më shteg*, etj.;

- për të treguar mënyrën e kryerjes së veprimit: *buzë më buzë, gojë më gojë, gju më gju, kokë më kokë, kurriz më kurriz, vesh më vesh* etj.

j) Nga përsëritja e një emri me ndërmjetësinë e parafjalës *pas*. Gjymtyra e parë e këtij lokucioni është në emërore të pashquar, ndërsa e dyta në rrjedhore të pashquar. Të tilla janë lokucionet *brez pas brezi, ditë pas dite, dorë pas dore, hap pas hapi, herë pas here, kohë pas kohe, orë pas ore* etj. Këto përsëritje kanë zakonisht kuptim kohor.

k) Në lokucionet e formuara nga përsëritja e të njëjtit emër një tip të veçantë përbëjnë ndërtimet *parafjalë (nga) + emër në rasën emërore të shquar + parafjalë (në) + emër në rasën kallëzore të pashquar*. Të tilla janë lokucionet: *nga dita në ditë, nga çasti në çast, nga koha në kohë, nga ora në orë, nga viti në vit* etj.

l) Lokucione ndajfoljore të formuara nga një parafjalë dhe një numërorë, ose nga përsëritja e një numërori me ndërmjetësinë e një parafjale: *për një, për dy, për tre; më dysh, më trish, më katërsh; një nga një, dy nga dy, tre nga tre, katër nga katër*, këto tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit.

m) Lokucione ndajfoljore të tipit *ndajfolje + parafjalë + ndajfolje*: *aty për aty, brenda për brenda, drejt për drejt, kot për kot, pak nga pak, sot për sot, tani për tani, vetëm për vetëm* etj, edhe këto tregojnë mënyrë.

n) Lokucione ndajfoljore të formuara nga parafjala *me* dhe një mbiemër i emëruar i gjinisë asnjansë, p.sh.: *me të butë, me të egër, me të keq, me të mirë, me të pabesë, me të qeshur, me të qetë, me të shpejtë, me të urtë*, për të treguar mënyrën e kryerjes së veprimit.

o) Lokucione ndajfoljore të formuara nga një parafjalë dhe një emër i pashquar dhe të shndërruar si kuptimisht dhe gramatikisht në njësi të qëndrueshme dhe të pandashme, me

vlerë dhe tipare ndajfoljore. Të tilla janë togjet: *me hir, me kohë, me natë, me ngut, mepahir, me radhë, me vrap, për bukuri, për turp, prej kohësh, me këmbë, në tym*, etj (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002, f. 378-380).

Ndajfolje të përngjitura

Një pjesë jo e vogël ndajfoljesh janë formuar me përngjitje. Grupin më të madh e përbëjnë ndajfoljet e formuara nga përngjitja e një togfjalëshi, ku njëra nga pjesët përbërëse është një përemër, ose ndajfolje përemërore. (Jashari & Çitaku, 2012, f. 112). Sipas elementeve përbërëse, dallohen disa grupe strukturore ndajfoljesh të përngjitura:

a) ndajfolje të përngjitura përemërore, ku si element i parë i përngjitjes është përemri *gjithë*, ndërsa si element i dytë mund të jetë një ndajfolje përemërore, një emër apo një pjesë tjetër e ligjëratës. Të tilla janë: *gjithandej, gjithashtu, gjithherë, gjithmonë, gjithnjë*.

b) ndajfolje të përngjitura përemërore, ku si element i parë i përngjitjes është një nga ndajfoljet përemërore pyetëse: *kur, ku, nga, si, qysh, tek*, ndërsa si element i dytë folja *do*. Të tilla janë: *kudo, ngado, sido, sado, tekdo*.

Në këtë grup hyjnë edhe përngjitjet, ku ndajfoljet përemërore dalin si gjymtyrë të dytë, ndërsa si gjymtyrë e parë del folja *di*. Të tilla janë: *diku, dikur, disi*.

c) ndajfolje të përngjitura, ku si element i dytë i përngjitjes del ndajfolja përemërore *ku* në formën *kund e kundi*, ndërsa si elementi parë mund të jetë një përemër, një ndajfolje apo një pjesëz si: *asgjëkundi, askund, askurrkund, kurrkund, gjëkundi, tjetërkund*.

d) ndajfolje të përngjitura, ku si element i dytë i përngjitjes del emri *herë*. Si element i parë mund të jetë një parafjalë, ndajfolje, përemër ose pjesëz. Të tilla janë ndajfoljet: *asnjëherë, atëherë, menjëherë, nganjëherë, përherë, përnjëherë*.

e) ndajfolje të përngjitura të formuara nga një parafjalë dhe një emër. Në këtë grup hyjnë: *përballë, përdhe, përkrah, përmes, përditë, përnatë, përherë etj*.

f) ndajfolje të përngjitura, elementet përbërëse të të cilave janë dy emra të lidhur ose jo me zanore lidhëse; si element përbërës mund të jetë edhe një pjesë tjetër e ligjëratës më shpesh ndajfolje. Të tilla janë: *fytafyty, anekënd, turravrap, kryekëput, kryekreje, motmot, shpeshherë, rrallëherë, rrallëkund, buzagaz etj*. Formimet e këtij tipi mund të merren në gjendjen e sotme si fjalë të përbëra.

g) ndajfolje të përngjitura të formuara nga një numëror dhe emri *fije* (fill) në rrjedhore të pashquar shumësisht me mbaresën *-sh*, si: *dyfish, trefish*, etj. Ndajfoljet e këtij tipi mund të merren si formime prapashtesore; emri *fije* (fill) është shndërruar në prapashtesë në trajtën *fish*, duke humbur jo vetëm tiparet leksikore, por edhe duke pësuar ndryshime fonetike.

h) ndajfolje të përngjitura me pjesë të ndryshme të ligjëratës si elemente përbërëse. Këtu hyjnë: *ndërkaq, sakaq, dosido, njëlloj, kësisoj, kësodore, sidokudo, vetvetiu* etj.

Ndajfolje të formuara me prapashtesa

Formimi i ndajfoljeve me anë të prapashtesave është një tip mjaft prodhimtar. Prapashtesat që përdoren më shumë janë: **-(i)sht, -as\azi** dhe **-thi**. Këtyre mund t'u shtohet edhe prapashtesa **-çe** që është karakteristike për gjuhën e folur. Në gjuhën e sotme letrare po zhvillohet gjerësisht tipi i ndajfoljeve që përmbajnë prapashtesën **-shëm**. Me anë të prapashtesave formohen kryesisht ndajfoljet e mënyrës. Prapashtesat ndajfoljore bashkohen me tema emërore dhe mbiemërore e më rrallë edhe me tema ndajfoljore.

a) Prapashtesa **-(i) sht** është prapashtesa ndajfoljore më prodhimtare në shqipen e sotme letrare. Ajo lidhet kryesisht me tema jo të parme që mbarojnë me **-i**, duke dalë kështu prapashtesa në trajtën **-sht**. Për analogji me këto janë formuar ndajfolje edhe nga tema fjalëformuese që nuk mbarojnë me **-i**, duke u zgjeruar prapashtesa në **-isht**, si: *natyrisht, ushtarakisht* etj.

Me të janë formuar ndajfolje:

- nga emra abstraktë të gjinisë femërore të formuar me prapashtesën **-(ë)si**, si: **egërsi-sht, gjerësi-sht, hollësi-sht, imtësi-sht, fatmirësi-sht, fatkeqësi-sht**, etj.;

- nga emra abstraktë të gjinisë femërore të formuar me prapashtesën **-(ë)ri**, si: **besnikëri-sht, burrëri-sht, pleqëri-sht, trimëri-sht**, etj.;

- nga emra abstraktë të gjinisë femërore të formuar me prapashtesën **-i**, si: **bujari-sht, dhelpëri-sht, njerëzi-sht** etj. Sipas këtij tipi janë formuar edhe ndajfoljet që shënojnë gjuhën e një populli a një dialekt, të tilla si: **arbëri-sht, bullgari-sht, çamëri-sht**, etj.;

-nga emra abstraktë të gjinisë mashkullore të formuar me prapashtesën **-im**, si: **detyrim-sht, përfundim-sht, gabim-isht, qëllim-sht, shkurtim-isht**, etj.;

- nga një numër i kufizuar emrash të parme të gjinisë femërore e mashkullore, si: **natyr-isht, rregull-isht, zakon-isht**.

b) Një kategori e gjerë ndajfoljesh është formuar nga bashkimi i prapashtesës –(ë)**sht** me tema fjalëformuese mbiemërore. Të tilla janë ndajfoljet: **absolutisht, arbitrarisht, artistikisht, barbarisht, mesatarisht, ushtarakisht** etj. Në formimet ndajfoljore të këtij tipi mbizotërojnë ato që janë formuar mbi bazën e temave të mbiemrave të huazuar nga gjuhë të tjera. (*Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002, f. 373-374*).

c) Një prapashtesë tjetër prodhimtare është edhe prapashtesa –**as**- **azi**. Ajo bashkohet:

- me tema emërore të parme, si: **fyta** e **fytazi**, **barkas** e **barkazi**, **rradhas** e **rradhazi**, etj.;

- me tema mbiemërore, si: **fshehtazi, anasjelltas, djathtas** e **djathtazi**, **majtas** e **majtazi**, **përçiptas** e **përçiptazi**;

- me tema ndajfoljore: **haptazi, keqas, largas, lartas** e **lartazi**, **shkurtas** e **shkurtazi**;

- me tema foljore: **befas, falas, ndarazi, fshehuras** e **fshehurazi**, **vjedhuras** e **vjedhurazi**, **rrëshqitas** e **rrëshqitazi**, **heshturazi**, **shkarazi** etj.;

- me tema jo të parme: **këmbadoras (-azi), prishaqejfas (-azi), doradoras (-azi)** etj., të cilat janë formuar me përngjitje apo përbërje dhe me prapashtesë njëkohësisht.

Prapashtesa –**thi** bashkohet:

- me tema emërore të parme: **arithi, cingëlthi, çapthi, mullarthe, qirithi, topti, trupthi** etj. Ky tip i kufizuar përdoret më shpesh për emërtimin e lojërave të ndryshme;

- me tema emërore jo të parme të formuara me prapashtesën –**im**: **fluturimthi, rrëmbimthi, nxitimthi, kalimthi, vetëtimthi**, etj.; në të tilla raste prapashtesa bashkë me temën tregon që veprimi kryhet në mënyrë të shpejtë e të menjëhershme;

- me tema mbiemërore: **çalamanthi, qorthi**;

- me tema ndajfoljore: **përseprapthi, rrëshqanthi**.

d) Bashkimi i prapashtesës –**thi** me tema mbiemërore dhe ndajfoljore është mjaft i kufizuar.

Disa ndajfolje janë formuar me prapashtesën –**thi** dhe me përngjitje në të njëjtën kohë: të tilla janë ndajfoljet: **brezahypthi, pulaqorthi, symbyllthi** që emërtojnë lojëra të ndryshme dhe lidhen kryesisht me këtë sferë, prandaj janë të kufizuara në përdorim e ndeshen kryesisht në gjuhën e fëmijëve.

e) Mjaft ndajfolje dalin sot me prapashtesën –**shëm**. Shumica prej tyre përputhen me trupin e mbiemrave me këtë prapashtesë, po ka një prirje për të zhvilluar ndajfolje të tilla pavarësisht nga mbiemrat. Të tilla janë ndajfoljet: **fuqishëm, furishëm, gëzueshëm, hareshëm, mendueshëm, natyrshëm, shterueshëm, rrjedhshëm, idhshëm, inatshëm, mallshëm** etj.

f) me prapashtesën –**çe**, me burim nga turqishtja, janë formuar disa ndajfolje nga tema emërore. Të tilla janë: **budallallëkçe, çapkënçe, derrçe, fshatarçe, fshatçe, hajduçe, halldupçe, këmesoreçe** etj. Kuptimi keqësues apo përqeshës që karakterizon disa nga këto ndërtime, lidhet fort me temën, me të cilën bashkohet prapashtesa. Në mjaft raste vendin e saj e ka zënë prapashtesa –**(i)sht**.

g) me prapashtesën –**sh**, që vjen nga shndërrimi i morfemës trajtëformuese të rrjedhore në prapashtesë, dalin ndajfolje si: **cinglash, kukullash, luftash, petash, rrasash, visash** etj.

1.4.2.Parafjalët

Parafjala është fjalë ose shprehje e pandryshueshme e ligjëratës që shpreh marrëdhënie varësie ndërmjet fjalëve dhe është fjalë shërbyese në fjali e që rrijnë para emrave, ndajfoljeve, e fjalëve në funksion të emrit (*Beci,2010,f.132*). Fjala nga e cila varet gjymtyra me parafjalë, mund të jetë folje, emër, mbiemër, numëror ose ndajfolje por më tepër parafjalët lidhin një emër me një folje(*Jashari & Çitaku,2012,f.116*).

Parafjalët janë fjalë shërbyese dhe ato nuk mund të përdoren si gjymtyrë fjalie. Është e rëndësishme të përmendet që parafjalët përdoren në të gjitha rasat, me përjashtim të rasës dhanore.

Klasifikimi i parafjalëve sipas prejardhjes

Sipas prejardhjes parafjalët janë:

a) **të parme**

b) **jo të parme.**

Parafjalët e parme janë: **mbi, me, më, ndaj, ndër, në, nën, pa, për, prej, tek.**

Parafjalët jo të parme janë më shumë se ato të parmet, dhe kryesisht formohen me konversion

Parafjalët jo të parme janë më të shumta se parafjalët e parme.

Sipas pjesëve të ligjëratës nga janë formuar, parafjalët jo të parme ndahen në dy grupe:

a) **parafjalë ndajfoljore**

b) parafjalë emërore.

Parafjalë ndajfoljore: para, pas, përballë, përbri, përpara, përreth, prapa, sipër, anembanë, drejtë, gjatë, këtej, krahas, përpos, përsipër, poshtë, pranë, rreth, rrotull, tatëpjetë, tutje, veç etj. P.sh. *U zhvilluan aktivitetet brenda e jashtë shkollës.* Është e rëndësishme të thuhet se të gjitha parafjalët ndajfoljore përdoren në rasën rrjedhore. Bëjnë përjashtim lokucionet ndajfoljore: **ballë për ballë me, bashkë me, tok me.**

Parafjalë emërore- Disa emra më parë janë shndërruar në ndajfolje e me vonë në parafjalë. Ato janë: **anës, rreth, rrotull.** P.sh. *Sillej rrotull shtëpisë.* Ka emra që janë shndërruar drejtpërdrejtë në parafjalë si: **majë, rrëzë, faqe, ballë, mes** etj. P.sh: *Buzë liqenit kishte shumë njerëz.*

Pjesa më e madhe e parafjalëve emërore janë në formë lokucionesh. Ato janë formuar në këtë mënyrë:

- a) Parafjalë+emër: **me anë, me përjashtim, me rastin, në drejtim, në sajë, në mes, në vend, nga ana, nga shkak, për shkak** etj. P.sh. *Qëndroi në mes të oborrit.*
- b) Parafjalë+emër+parafjalë :**në krahasim me, në kundërshtim me, në lidhje me, në përputhje me** etj. P.sh. *Festivali u organizua në bashkëpunim me këngëtarët.*

Këto përdoren në rasën dhanore për arsye se kanë në fund parafjalën **me**. Parafjalët emërore, janë karakteristike për stilin shkencor, politiko-shkencor dhe administrative, megjithatë, lokucioni parafoljor dallohet nga një bashkim i lirë që ka po atë ndërtim.

Shembuj krahasues:

Në bazë (në themel) të ligjeve tona qëndron koncepti bashkëkohor (emër).

Kjo çështje do të zgjidhet në bazë të ligjeve (parafjalë) (Jashari&Çitaku,2012,f.117).

Sipas **kriterit sintaksor** parafjalët klasifikohen varësisht se në cilën rasë përdoren. Ato ndahen në parafjalë të rasës **emërore, gjinore, kallëzore dhe parafjalë të rasës rrjedhore.**

Parafjalët e rasës emërore

Me rasën emërore përdoren parafjalët **nga** dhe **te(k)**.

Gjymtyra e prirë nga parafjal **nga** mund të tregojë:

- a) **vend, prejardhje:** *Është nga bjeshkët e veriut. Rrinin ulur dhe vështronin nga kodra.*
- b) **shkak:** *Dëbora ishte shkrirë nga shiu që kishte rënë gjatë natës.*
- c) **kohë:** *Nga fundi i dhjetorit ta dëbora e parë. Duku një herë nga java.*
- d) **kufizim:** *E dua nënën, se është e madhe nga zemra.*
- e) **vepruesin:** *Mësimi i zhvilluar nga mësuësja e re u vlerësua nga të gjithë pjesëmarrësit.*
- f) **të tërën nga e cila është ndarë një pjesë:** *Artani është një nga këngëtarët më të mirë të grupit.*

Parafjalët e rasës gjinore

Me rasën gjinore përdoren vetëm **lokucione parafoljore**, si: **me anë, me anën, për shkak, për arsye, në vend, në drejtim, në bazë, në sajë** etj. (Jashari & Çitaku, 2012, f.118).

Ato tregojnë :

- a) **mjet - me anë, me anën:** *Kjo çështje u la të zgjidhej me anë të bisedimeve.*
- b) **marrëdhënie vendore-në drejtim:** *Djali ecte në breg në drejtim të rrymës.*
- c) **synimi e kufizimi**-(stili politik-shoqëror): *U bënë përpjekje në drejtim të përmirimit të shëndetit të fëmijëve.*
- d) **zëvendësim, këmbim- në vend:** *Të kam në vend të vëllait.*
- e) **shkak: për arsye, për shkak, nga shkaku:** *Kongresi i Manastirit pati rëndësi të madhe për arsye të kushteve në të cilat ndodhej gjuha jonë.*

Parafjalët e rasës kallëzore

Me rasën kallëzore përdoren shumë parafjalë të thjeshta: **në, me, më, për, pa, mbi, ndër** dhe lokucione, si: **bashkë me, tok me, në bashkëpunim me, në krahasim me, në kundërshtim me, në lidhje me** etj.

Gjymtyra e prirë nga parafjala **në** tregon:

- a) **vendin :** *Lirinë e kishit kudo, në kraharor, në ballë, në shpatë dhe në ushtat.*
- b) **kohën:** *Kanalin e mbaruam në ditët e para të shtatorit.*
- c) **kufizimin:** *Është i kursyer në fjalë.*
- d) **një cak sasior:** *Grupi i teatrit u rrit në 15të veta.*

Gjymtyra e prirë nga parafjala **me** tregon:

- a) **shoqërim, bashkim, marrëdhënie:** *Shkoi në kinema **me** motrën. Gatoi mish **me** patate. Sillej mirë **me** shokët.*
- b) **kohë:** *Kur fillonin shirat, rrinte **me** ditë pa ardhur në shtëpi.*
- c) **kufizim:** *Nuk donte të ndahej nga ne, sado që **me** moshë ishte i vogël.*
- d) **lëndën nga e cila ndërtohet ose mbushet një send:** *Shtëpia ishte ndërtuar **me** tulla.*
- e) **shkak:** *Të gjithë qeshnin **me** shakatë e mësuesit.*
- f) **tipar, cilësi:** *Pyjet **me** ah janë shumë të bukura.*

Gjymtyra e prirë nga parafjala **pa** tregon mungesë, përjashtim të një sendi a personi:

- a) **mungesë shoqërimi, bashkimi:** *Salla ishte **pa** njerëz.*
- b) **mungesë mjeti:** *Interesante si i kanë bërë këto pallate, **pa** mjetet e teknikës së sotme.*
- c) **mënyrë:** *Ai përgjigjej **pa** druajte.*
- d) **tipar:** *Deti nuk dukej, se nata ishte **pa** hënë e **pa** yje.*
- e) **kusht:** *Në një kohë të tillë, **pa** mushama, **pa** çizme, është vështirë të punosh me çekiç në dorë përjashta.*

Gjymtyra e prirë nga parafjala **për** mund të tregojë:

- a) **qëllim, synim:** *Lëvizja **për** shkollën, **për** arsimin shqip ishte lëvizje me karakter kombëtar.*
- b) **shkak:** ***Për** një pe, **për** një gjilpërë vajti dëm një punë e tërë.*⁵
- c) **kohë:** *Punën e sotme mos e lerë **për** nesër.*
- d) **vend:** *U nis **për** Tiranë.*
- e) **kufizim:** *Mira shquhej **për** zërin e bukur.*
- f) **objektin e të folurit:** *Sot folëm **për** krijimtarinë e Naimit.*

Gjymtyra e prirë nga parafjala **mbi** mund të tregoi:

- a) **Vendin** mbi të cilin ndodh një veprim e gjendet diçka: *Aeroplani këtë radhë fluturoi fare ulët **mbi** kokat tona.*

b) objektin e të folurit, mendimit, ndjenjave etj. *Ka shkruar një artikull mbi parafjalët.*

Parafjalët e rasës rrjedhore

Me rasën rrjedhore përdoren parafjalët e parme: **prej, ndaj, për, etj.** Gjymtyra e paraprirë nga parafjala **për** mund të tregojë: (*Jashari & Çitaku, 2012, f. 162*).

- a) **vend a prejardhje:** *Makina u nis vone prej Tirane.*
- b) **lëndën prej së cilës përbëhet një send:** *Vizitorët e njihnin mirë materialin prej qeliku.*
- c) **tipar a cilësi:** *E shikonte në sy me një buzëqeshje prej miku.*
- d) **kohë:** *Nuk ishin parë që prej dy vitesh.*
- e) **sasi:** *Fjalët e përbëra formohen prej dy a më shumë temash.*

Për nga ana e strukturës parafjalët mund të jenë: **fjalë të thjeshta, të përngjitura dhe lokucione.**

- a) Të thjeshta janë parafjalët: **mbi, me, më, ndaj, ndër, nën, pa, për, prej te (k).**
- b) Të përngjitura janë parafjalët e formuara nga përngjitja e dy fjalëve të veçanta: **nëpër, përmbi, ndërmjet, përmbri** etj.
- c) Lokucione janë ato parafjalë që formohen prej dy a më shumë fjalëve të veçanta: **ballë për ballë, rreth e qark, në bazë** etj.

1.4.3. Lidhëzat

Lidhëza është ajo pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që lidh dy gjymtyrë fjali ose dy fjali dhe shpreh marrëdhënie të ndryshme sintaksore ndërmjet tyre (*Jashari & Çitaku, 2012, f. 121*). Ato nuk mund të përdoren si gjymtyrë fjali për arsye se ato nuk kanë një kuptim leksikor të pavarur. Vlen të përmendet që ato kanë një ngjajshmëri më parafjalët dhe shpesh përdoren në vend të njëra tjetrës por dallimi i tyre është që parafjalët lidhin gjymtyrë fjalish dhe dy pjesë të ligjëratës ndërsa lidhëzat lidhin kryesisht fjali dhe fjalë që i takojnë të njëjtës pjesë të ligjëratës.

Lidhëzat klasifikohen sipas:

- a) Prejardhjes
- b) Funksionit sintaksor

Lidhëzat sipas prejardhjes ndahen në lidhëza :

- a) **të parme**
- b) **jo të parme.**(lidhëza te formuara me konversion, me përngjitje dhe lokucione lidhëzore).

Lidhëzat e parme janë: **e, dhe, edhe, apo, as, o, ose, o, por etj.**

Lidhëzat jo të parme janë të gjitha të tjerat dhe ndahen në tri grupe:

- a) **Lidhëza të formuara me konversion** nga pjesë të ndryshme të ligjëratës hyjnë lidhëzat **që, sa e se,** që kanë dalë prej përemrave përkatës lidhorë e pyetës, lidhëzat **ku, kur, nga, tek, veç,** që kanë dalë nga ndajfoljet përkatëse, ndërsa lidhëzat **daç e qoftë,** që kanë dalë përkatësisht nga trajta e vetës së dytë dhe vetës së tretë njëjës të dëshirores së foljeve dua e jam, si dhe lidhëza veçuese **a,** që vjen prej pjesëzës pyetëse .(Agalliu, Angoni, Demiraj, Dhrimo, Hysa, Lafe & Likaj, 2002, f.399).
- b) **Lidhëza të formuara nga përngjitja** e dy fjalëve: **nëse, porse, meqë, ngaqë, ndërsa, gjersa, mirëpo etj.** (Jashari&Çitaku,2012,f.121).
- c) **Lokucione lidhëzore:** në **qoftë se, për shkak se, në vend të, në rast se ,qysh se ,sa herë që etj.** këto lidhëza janë formuar me anë të një lidhëze dhe të një përemri lidhor :**kurdoherë që, deri kur, edhe sikur etj.**
- d) Kemi edhe **lidhëza dyshe për arsye** që ato përdoren të ndara në dy pjesë **qoftë...qoftë, jo vetëm që...por edhe, le që... por as etj.**

Klasifikimi i lidhëzave sipas kriterit sintaksor

Nga pikëpamja e funksionit sintaksor lidhëzat ndahen në dy grupe kryesore:

1. Lidhëza bashkërenditëse

2. Lidhëza nënrenditëse

1. **Lidhëzat bashkërenditëse** shprehin raport barazie, dhe shërbejnë për të lidhur dy gjymtyrë ose dy fjali të një fare (të dyja të pavarura, kryesore ose të varura). Sipas marrëdhënieve që shprehin në fjali ato ndahen në:

- a) **Lidhëza këpujore**
- b) **Lidhëza veçuese**
- c) **Lidhëza kundërshtore**
- d) **Lidhëza përmbyllëse**
- e) **Lidhëza të shkallëzimit**

1. **Lidhëzat nënrenditëse** shprehin raporte vartësie. Ato shërbejnë për të lidhur një pjesë të nënrenditur. Edhe këto ndahen në:

- a) **Lidhëza fthiluese**
- b) **Lidhëza vendore**
- c) **Lidhëza shkakore-qëllimore**
- d) **Lidhëza krahasore-mënyrore**
- e) **Lidhëza kushtore**
- f) **Lidhëza rrjedhore**
- g) **Lidhëza lejore**
- h) **Lidhëza kundërvënëse**

Lidhëzat bashkërenditëse dhe llojet e saj

- **Lidhëzat këpujore:** shprehin një bashkim të thjeshtë gjymtyrësh . Ato janë: **e, edhe, dhe, as, etj.** P.sh: *Kur anija u afrua në port **dhe** filloi të ngadalësojë njerëzit që qëlluan aty filluan të shpërndareshin.*

- **Lidhëzat veçuese:** tregojnë se pjesët e fjalive të lidhura prej tyre përjashtojnë njëra tjetrën: **a, apo, o..o, daq...daq, ja..ja etj:** P.sh: ***O** do të nisem sonte, **o** nuk do të nisem fare.*

- **Lidhëzat kundërshtuese:** shprehin marrëdhënie kundërshtore: **po, por, mirëpo, kurse, megjithëse, teksa, porse, veçse, vetëm se.** P.sh: *E quajti gjë të lehtë, mirëpo me kalimin e kohës e pa se sa e vështirë ishte.*

- **Lidhëzat përmyllëse:** këto vendosen para një fjalie e cila tregon se është diçka në përfundim si pasojë e asaj që thuhet më përpara: **andaj, prandaj, pa:** P.sh: *U pendova që i fola aq ashpër, prandaj i kërkova shumë të falur.*

- **Lidhëzat e shkallëzimit:** janë në formë lokucionesh: Ato janë: **jo që...por edhe, jo që.. po, jo vetëm që...por as, le që.. por edhe etj.** P.sh: *Aty jo vetëm që ishte shumë ftohtë por edhe binte dëborë shumë.*

Lidhëzat nënrenditëse

-**Lidhëzat ffilluese:** tregojnë lidhjen e varësisë ndërmjet një pjese të nënrenditur dhe asaj drejtuese. Ato janë: **se, që, në, nëse, sikur etj.** P.sh: *Dihet që Jana e donte shumë muzikën.*

- **Lidhëzat vendore:** ndërtojnë fjali që shprehin lloje marrëdhënie vendore. Ato janë: **ku, tek, kudo, ngado, deri kur, gjer ku, nga ku, kudo që, ngado që etj.** P.sh. *Ngado që kaloja e nuhasja aromën e mirë të luleve.*

- **Lidhëza kohore:** ndërtojnë fjali që shprehin marrëdhënie kohore. Ato janë: **kur, sa, si, tek, porsa, që kurse, qysh se, sa kohë që, sapo që, kurdoherë që etj.** P.sh *Saherë që vija në shtëpi më kujtohej ajo erë e bukës që me ngjallte shumë nostalgji.*

- **Lidhëza shkakore :**ndërtojnë fjali që shprehin marrëdhënie shkakore :Ato janë: **se, sepse, si, sapo, meqënëse, duke qenë se, nga shkakun se, posa që, nga frika se etj.**P.sh *Unë u gëzova pa masë kur e pashë sepse ishte njeri për tu admiruar.*

- **Lidhëza qëllimore:** ndërtojnë fjali që shprehin marrëdhënie qëllimore. Ato janë: **që, me qëllim që, në mënyrë që.** P.sh: *Më shikonte më ngulm në mënyrë që të flisja diçka për të.*

- **Lidhëzat krahasore-mënyre:** shërbejnë për të ndërtuar fjali që shprehin marrëdhënie krahasore ose mënyrore: Ato janë: **sa, se, si, sesa, sikurse, ashtu siç** etj. P.sh: *Sa më shumë që mëson aq më shumë do të arrish në jetë.*

-**Lidhëzat kushtore:** ndërtojnë fjali që shprehin lloje të ndryshme marrëdhënies kushtore: Ato janë: **në, po, nëse, sikur, në qoftë se, ne rast se, me kusht që** etj. P.sh: *Po që se e pamë të arsyeshme do të nisemi që sonte.*

-**Lidhëzat rrjedhimore:** shërbejnë për të ndërtuar fjali me marrëdhënie rrjedhimore: Ato janë: **sa, saqë, që, aq sa, kështu që** etj. P.sh: *Vend s'kishte për të gjithë, kështu disa nuk erdhen fare.*

-**Lidhëzat lejore:** shërbejnë për të ndërtuar fjali me marrëdhënie lejore: Ato janë: **megjithëse, edhe në qoftë se, edhe po, edhe pse, edhe sikur** etj. P.sh. *Edhe po te doja të të ndihmoja nuk do të mundja.*

- **Lidhëzat kundërvënëse:** tregojnë kundërvënie në mes të dy gjendjeve: Ato janë: **në qoftë se, ndërsa, në vend që** etj. P.sh: *Në vend që të qash, më mirë është që të dëgjosh.*

Vlen të përmenden edhe **lidhëzat sqaruese ose shpjeguese** që sqarojnë, saktësojnë dhe zbërthejnë kuptimin e një fjale ose të një gjymtyre tjetër. Ato janë: **domethënë, bie fjala, për shembull, apo, ose** etj. P.sh: *Ajo ishte vajza ime domethënë e paske njohur.*

1.4.4 Pjesëzat

Pjesëza është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që shërben për të shprehur nuanca kuptimore ose emocionale plotësuese të një fjale, të një togfjalëshi ose të një fjalie të tërë. (Jashari & Çitaku, 2012, f.125). P.sh. *Pikërisht në atë çast u dëgjua një këngë e fuqishme.* Pjesëzat nuk kanë një kuptim leksikor të pavarur dhe nuk mund të jene gjymtyrë fjalie por ato kushtëzohen vetëm nga konteksti.

Sipas vendit që zënë në fjali pjesëzat mund të ndahen në dy grupe:

1. Pjesëza me vend të ngulitur në fjali

2 .Pjesëza me vend të lirë

1. Pjesëzat me vend të ngulitur mund të jenë:

a) **Gjithmonë të paravendosura**(para fjalës ose togfjalëshit). Ato janë: **nuk, nja, desh, sapo** etj. (*nuk foli, sapo doli* etj)

b) Gjithmonë të prapavendosura si: *de, dot etj (fol de, se mori dot etj)*.

2. Pjesëzat me vend të lirë mund të zënë vende të ndryshme në fjali. Ato janë: **:a, bile, ndoshta, vallë, etj**: P.sh: *Vallë a ju kujtohet ajo ngjarje?*

Për nga ana e strukturës morfologjike pjesëzat ndahen në:

- a) Fjalë të thjeshta-*mu, bile, jo, nuk, po, vallë, as, dot etj*
- b) Fjalë të përngjitura-*posi, sic, thuajse, kushedi etj,*
- c) Lokucione-*as që, jo që jo , ,po se po, pa le se, mos vetëm se etj.*

Për nga domethënia pjesëzat ndahen në:

- 1) Pjesëza që shprehin nuanca kuptimore të përgjithshme
- 2) Pjesëza modale
- 3) Pjesëza emocionuese-shprehëse

2. Pjesëza që shprehin nuanca kuptimore të përgjithshme – shërbejnë për të shprehur nuance kuptimore plotësuese të një fjale të veçantë të një togfjalëshi apo të një fjali të tërë (*Jashari & Çitaku, 2012, f.127*).

Në këtë grup hynë pjesëzat

- a) dëftuese
- b) përcaktuese-saktësuese
- c) përforcuese
- d) përfruese

a) Pjesëza dëftuese- është vetëm pjesëza **ja-** e cila shërben për të treguar diçka ose dikë që gjendet zakonisht në afërsi. P.sh. **Ja** shkolla jonë. Sinonimike është edhe pjesëza **qe**. P.sh. **Qe**, erdha. **Qe** dora.

b) Pjesëza përcaktuese-saktësuese-përcaktojnë ose saktësojnë më mirë kuptimin e fjalës të togfjalëshit, a të fjalisë. Ato janë: **mu, pikërisht, taman, bash, plot, rrumbullak** etj. P.sh. Mësuesi e puthi **mu** në ballë.

c) Pjesëzat përforcuese- shërbejnë për të përforcuar kuptimin e një fjale të një togfjalëshi, a të një fjalie. Ato ndahen në:

- **Pjesëza përforcuese kufizuese:** Ato janë: **vetëm, veç, veçse, sidomos etj: P.sh:** *Mitrovica është qytet shumë i bukur veçanarisht në verë.*
- **Pjesëza përforcuese shtuese:** Ato janë: **dhe, edhe, madje, bile, as etj. P.sh:** *Ajo po pret, madje që tani.*
- **Pjesëza përforcuese thirrëse:** Ato janë: **o, or, ore, moj, more etj** dhe shërbejnë për të përforcuar thirrjen nga emri ose përemri. **P.sh:** *Shqipëri, o mëma ime, ndonëse jam i mërguar...*

d) Pjesëza përfruese : Ato janë: **afro, aty-aty, nja, si nja, gati, rreth, thuajse, mend etj.** Ato e paraqesin kuptimin e fjalës të përfaqësuar e jo me saktësi. **P.sh:** *Në festival morën pjesë rreth dyzet veta.* Pjesëzat **desh** dhe **mend** përdoren vetëm para foljeve për të treguar një veprim të pakryer: P.sh. *Për pak desh rrëshqiti.*

Pjesëza modale- shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj mendimeve, ndaj vërtetësisë së një ngjarjeje a dukurie të realitetit. *(Jashari & Çitaku, 2012, f.127).*

Ato janë pesë llojesh:

- | | |
|------------|-------------|
| a) pohuese | c) dyshuese |
| b) mohuese | e) zbutëse |
| c) pyetëse | |

- Pjesëzat pohuese:** **po, posi, po që po, po se po etj. P.sh:** *Po, ky është mendimi im.* Në ligjërimin bisedor si pjesëza pohuese përdoren edhe: **e, ëhë, etj. P.sh:** *Do të vish? Ëhë.*
- Pjesëzat mohuese:** **jo, nuk, s', mos, jo që jo, jo se jo, as që etj. P.sh:** *Jo, nuk i kam treguar askujt për këtë.*
- Pjesëzat pyetëse:** **a, ë, e që shërbejnë për të pyetur.** Përdoren në fjali pyetëse dhe në fjali retorike: P.sh: *A mund të përvetësohet dituria pa mësuar?*
- Pjesëzat dyshuese:** **ndoshta, mbase, kushedi, sikur, vallë, mos etj.** Këto pjesëza japin nuance dyshimi e pasigurie. Pjesëzat **vallë edhe gjë** përdoren vetëm në fjali pyetëse kurse të tjerat edhe në fjali jopyetëse. **P.sh:** *Përse më kërkon vallë?*
- Pjesëzat zbutëse:** **pa, as, le, para, dot etj. P.sh. Pa shih se sa është rritur.**
 - Pjesëza **pa dhe as** vihen para foljeve në mënyrën urdhërore për ta paraqitur urdhrin në formë dëshire: **Pa shih edhe ti çfar thua.**

- Pjesëza **le** vëhet para foljeve të mënyrës lidhore: P.sh: **Le të ngremë dolli për qiftin.**
- Pjesëza **para** përdoret vetëm me pjesëzat nuk dhe s' për të zbutur mohimin e shprehur prej tyre: P.sh: **Këtë para s'mbaj mend.**
- Pjesëza dot përdoret në fjali pyetëse, mohore dhe fjali kushtore. P.sh: **Nuk e takuat dot?**

Pjesëza emocionuse-shprehëse: shërbejnë për të theksuar anën emocionuese e forcën shprehëse të ligjëritimit. Ato janë: **ç', de, ora, se, seç** etj .Disa prej tyre siç janë pjesëzat **ç'** dhe **seç** theksojnë ndjenjën e kënaqësisë habisë, gëzimit, keqardhjes etj: P.sh: **Seç e prenë e seç e vranë.** Pjesëzat **de** dhe **pra** shërbejnë për të theksuar kuptimin e fjalës a fjalisë përkatëse: P.sh Ruaj zërin **de** të thash. Ndërsa pjesëza **pa** dhe **se** përdoren në fjali pyetëse për të theksuar anën emocionale: P.sh :**Pa** më thuaj, ç'ke me mua?

Si pjesëza emocionuese-shprehëse përdoren edhe shprehjet: **epo, ja që, le që, pa le** etj që ti japin gjallëri ligjëritimit: P.sh: **Pa le**, më thuaj?

Pjesëza gramatikore: u, do, të, me, për, pa, duke etj shërbejnë për formimin e disa trajtave gramatikore të foljeve:(**u lava, do të shkoj, te shkoj, me shkue, duke shkuar**)etj.

1.4.5.Pasthirma

Është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që shërben për të shprehur ndjenjat, dëshirat, a vullnetin e folësit, por pa i emërtuar ato. Ato përdoren në fillim të fjalisë por edhe në mes edhe në fund fjalie. Veçohen me presje, ndërsa kur përdoren vetëm vihet pikëquditëse. Ato ndryshojnë shumë nga pjesët tjera të ligjëratës dhe mund t'i numërojmë këto veçori të pasthirmave:

Ato janë fjalë që nuk emërtojnë.

- a) Janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës dhe përdoren në formë të ngurosur.
- b) Nuk kanë në përbërjen e tyre parashtesa ose prapashtesa.
- c) Ato nuk janë gjymtyrë fjalie.
- d) Janë karakteristikë më shumë për gjuhën e folur.

Sipas prejardhjes pasthirmat **ndahen në të parame** (që nuk kanë dalur nga ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës).Ato mund të jenë tinguj të veçantë ose grupe tingujsh:**a, e, ë, i, o, u, y, au, ba, hë, ama ahu etj.**

Pasthirmat janë edhe **jo të parme**(që vinë prej pjesëve të tjera të ligjëratës me anë të konversionit dhe me anë të përngjitjes).

Me anë të konversionit janë ato pasthirma që kanë ardhur nga format të ngurosurat të emrave dhe mbiemrave si: **korba, qyqja, o burrani, forca, e zeza, të keqen etj.** P.sh: **Forca.** Shtyjeni edhe pak.

Me përngjitje janë formuar pasthirmat: **Faleminderit, mirupafshim, lamtumirë, tungjatjeta etj.** Disa pasthirma janë edhe të bashkuara si :**dreq o punë, hej dreq, punë e madhe, dreqi ta hajë etj.** Jo të parme janë edhe disa pasthirma të huazuara nga gjuhë tjera: **alo, aman, hajde, marsh, etj.**

Sipas domethënies pasthirmat ndahen në:

1. **Pasthirma emocionuese:** që shprehin ndjenja si gëzimi, kënaqësi, habi, frikë, dhembje etj.
E njëjta pasthirmë mund të përdoret në kontekste të ndryshme dhe mund të shprehë ndjenja të ndryshme. Ato sipas ndjenjave që shprehin mund të ndahen në:
 - a) Pasthirma që shprehin habi: **au, ua, eu, oj, pa, uh.**
 - b) Pasthirma që shprehin frikë: **obobo, ubobo, kuku, qyqja, e zeza etj.**
 - c) Pasthirma që shprehin mospërfillje, përbuzje: **ama, ahu, pty etj.**
 - d) Pasthirma që shprehin paknaqësi, keqardhje, dëshpërim: **a, ah, e, of, uf, vaj etj.**
2. **Pasthirma urdhërore** shprehin vullnetin a dëshirën e folësit. Ato ndahen në:
 - a) Pasthirma që shprehin thirrje: **ej, hej, ore, or, more, moj, pst etj.** P.sh *More, mos ka rrezik?*
 - b) Pasthirma që shërbejnë si pjesëza përforcuese thirrëse: **o, ore, mor, more, moj.** P.sh *Ore bir, ç'i ke këto fjalë?*
 - c) Pasthirma që shprehin urdhër, nxitje ose lutje: **oburra, forca, hopa, hë, na, shët, të keqen etj. P.sh. Forca, jepi.**
 - d) Këtu hynë pasthirmat që u drejtojmë edhe kafshëve: **cit, ush, ish, pis etj.** P.sh: *Cit, moj mace se më trembe.*
 - e) Pasthirma që shprehin përsëritje, mirënjohje, urime: **Faleminderit, lamtumirë, mirëmëngjes, mirupafshim, mirë se erdhe, ditën e mirë, udha e mbarrë etj.**

II. KAPITULLI I DYTË

2.1. Plani dhe programi për lëndën e gjuhës shqipe për klasët 6,7 dhe 8

Sipas planprogramit të përgatitur nga MASHT për klasët 6,7 dhe 8 mësimi i lëndës së gjuhës shqipe zë një hapësirë me një përqindje me të madhe krahas lëndëve tjera. Ky planprogram përfshin qëllimet, objektivat, shkathtësitë e zhvillimit të të nxënësve duke përfshirë të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit që duhet t'i përvetësojnë nxënësit në kuadër të këtij planprogramit.

2.2. Fondi i orëve mësimore për lëndën e gjuhës shqipe për klasët 6,7 dhe 8

Fondi i orëve në lëndën e gjuhës shqipe për klasët e 6-ta, sipas plan programit të hartuar nga MASHT-i i ka 5 orë në javë, gjithsej 185 orë në vit. (Plani dhe programi mësimor 6, 2003). Gjithashtu edhe në klasë të 7-të dhe të 8-të fondi i orëve është 5 orë në javë, gjithsej 185 orë në vit.

2.3. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikën e klasës së 6

Libri “Gjuha shqipe 6” i hartuar nga Rugova, Elezi, Jakupi dhe Baftiu tekst ky që mësohet nga nxënësit e klasës së gjashtë të shkollave të mesme të ulëta ka gjithsej 37 njësi ,prej tyre për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës janë 3 njësi: ndajfolja, parafjala dhe lidhëza. Të gjitha njësitë mësimore të këtij libri, janë paraparë të zhvillohen gjatë procesit mësimor, brenda një ore mësimi, nëpër katër rubrika: Vështrojmë, Pyesim, Bashkëbisedojmë dhe Ushtrohemi.

Nëse e marim parasysh se çfarë dobie kanë nxënësit nga mësimi i gjuhës shqipe atëherë mësimi për pjesë të ligjëratës është shumë i mangët e sidomos për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës. Pjesa didaktike është shumë e varfër, pa asnjë sygjërim për detyrë të pavarur në mënyrë që për nxënësit të jetë më e lehtë që ta provojnë veten se a i kanë kuptuar mirë mësimin ashtu edhe që mësimdhënësi të ketë mundësi që të dijë se si janë nxënësit me mësimin. Përderisa te njësia për ndajfoljen nuk jepet asnjë përkufizim i saktë se çfarë janë ndajfoljet por me vetëm një ilustrim fotografie të varfër shpjegohen disa shembuj të ndajfoljes në mënyrë shumë të shkurtër.

Në rubrikën e parë “Vështrojmë” për ndajfoljen janë të vendosura disa fotografi në mënyrë që të shpjegohen se cilat janë ndajfolje. Aty shihet një nxënës duke vallëzuar tjetri duke vallëzuar me dikë tjetër dhe janë dhënë këto shpjegime:

Ti vallëzon **vazhdimisht**. Ai vallëzon **rrallë**. Unë vallëzoj **bukur**. Unë e ti vallëzojmë **bashkë**
Ajo vallëzon më **shpesh**.

Përmes rubrikës “Bashkëbisedojmë” aty është treguar se cilat prej këtyre janë ndajfolje: **bukur, vazhdimisht, rrallë, shpesh, bashkë** duke treguar në këtë mënyrë se këto ndajfolje tregojnë tipar të veprimit ose të gjendjes (foljes) , duke përfunduar këtu shpjegimin dhe duke mos dhënë asnjë informacion tjetër ,ndonjë përkufizim në lidhje me ndajfoljen ose së paku ndonjë shembull, përveç ilustrimit të disa fotografive. Çfarë është e rëndësishme të theksohet është që këtu kemi mungesë shumë të madhe të shembujve sepse me anë të shembujve tregohet më së miri shpjegimi i njësive mësimore.

Aty përmenden edhe llojet e ndajfoljeve të cilat janë të treguara me vetëm nga një shembull: **Ndajfolje mënyre** (plotëson foljen duke i dhënë përgjigje pyetjes si) *Do të ecim ngadalë.*

Ndajfolje sasi (plotëson foljen duke i dhënë përgjigje pyetjes sa) *Ai fliste pak dhe punonte shumë.*

Ndajfolje kohe (plotëson foljen duke i dhënë përgjigje pyetjes kur) *Natën është errësirë, ditën duket shumë mirë.*

Ndajfolje vendi (plotëson foljen duke i dhënë përgjigje pyetjes ku) *Aty ku shkon ai ,atje do të jem edhe unë.*

Ndajfolje shkaku (plotëson foljen duke i dhënë përgjigje pyetjes pse)

Më pas shpjegimi vazhdon duke treguar që ndajfoljet edhe për sa i përket ndërtimit ndahen në :

1. Të thjeshta: **mirë, keq, sot, këtu.**
2. Të përbëra: **besnikërisht, kalimthi, gjithmonë, menjëherë.**
3. Shprehje ndajfoljore: **ditë për ditë, lart e poshtë, copa-copa.**

Tregohen edhe për shkallët kryesore të ndajfoljes duke dhënë shembuj të njëjtë dhe të shkurtër për secilën prej tyre :

1. Pohore: Ajo fliste **shpejt**.
2. Krahasore: Ajo fliste **më shpejt**.
3. Sipërore :Ajo fliste **shumë shpejt**.

Në fund kemi edhe rubrikën e “Pyetjeve “ që janë gjithsej 5 pyetje të ndryshme mbi njohuritë për ndajfoljen që janë dhënë në rubrikat e mësipërme. Te rubrika e pyetjeve që është e vetmja rubrikë për përgjigje të nxënësve janë dhënë vetëm 5 pyetje të shkurtra dhe të prera me kërkim përgjigje po ashtu të shkurtra, dhe në këtë mënyrë duke mos lejuar zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve, për punë të pavarur. Me këto pyetje edhe përfundon e gjithë njësia për ndajfoljen, duke mos u shpjeguar më parë as se cilës pjesë të gramatikës i takon dhe pse quhen pjesë të pandryshueshme të ligjëratës në mënyrë që nxënësit të kenë të qartë njëherë e mirë.

Menjëherë pas shpjegimit të ndajfoljes në njësinë e 25 kemi të bëjmë me parafjalën e cila është e zhvilluar në rubrika: vështrim, diskutim, bashkëbisedim dhe detyra. Me një tekst letrar marrë nga Historia e Skënderbeut të Marin Barletit “ Lindja e Skënderbeut” janë nënvizuar parafjalët me të zeza dhe menjëherë pas tyre në vend që të kishte ndonjë përkufizim për parafjalën ose ndonjë informacion që nxënësit të kuptojnë më mirë se për çfarë bëhet fjalë aty janë dhënë tri pyetje të panevojshme dhe që nuk kanë të bëjnë fare me mësimin për parafjalën. Le ti shohim këto pyetje që janë dhënë: 1. Për kë bëhet fjalë në këtë tekst? 2. Çka dini për Skënderbeun? 3. Tregoni në klasë rrëfimet për Skënderbeun?

Këto janë tri pyetjet që nuk të çojnë fare nga mësimi për parafjalën por i japin orës mësimore një kahje tjetër. Te pjesa didaktike e këtij libri në vend që të ishte ndonjë detyrë që nxënësit të lexojnë ndonjë tekst letrar dhe t’i gjejnë vetë parafjalët aty iu kërkohet që vetëm të përshkruajnë tekstin letrar “Lindja e Skënderbeut” me fjalitë që kanë parafjalë, detyrë kjo që nuk mund të quhet edhe detyrë për arsye se kemi të bëjmë vetëm me një përshkrim të thjeshtë. Në mënyrë shumë të shkurtër në fund të faqes për parafjalën jepet një përkufizim fare i thjeshtë dhe ndarjet e parafjalës me disa shembuj shumë të paktë.

Më pas te një rubrikë ”Detyrë” nxënësit e kanë për detyrë që në një tabelë të shkruajnë të gjithë parafjalët bashkë me emrat dhe përemrat që janë shoqëruar në tekst.

Aty është dhënë një shpjegim për parafjalën duke treguar se çka është parafjala dhe si ndahet ajo në mënyrë shumë të shkurtër për nxënësit e klasave të 6- ta.

Aty është dhënë edhe ndarja e parafjalëve sipas rasave me të cilat përdoren:

- a) Rasa emërore: **nga, te (k) P.sh.** *Vërtet bujare nga ana juaj.P.sh Gëzofi i gjatë i zbriste deri te këmbët.*
- b) Rasa gjinore: **me anë, në drejtim, për punë, për shkak** etj. *P.sh. Suksesi arrihet me anë të punës së vazhdueshme.*

c) Rasa kallëzore: **në, me, për, mbi, nën, nëpër etj.** *P.sh Jetonte i vetëm në një kasolle të vogël.*

d) Rasa rrjedhore: **prej, ndaj, përveç, sipas etj.** *P.sh Vetëm njëri prej tyre është shqiptar. Rasa dhanore përdoret pa parafjalë.*

Edhe për parafjalën **te** dhe **tek** është që u duhet nxënësve që të dinë përdorimin e saj.

Parafjalët **te** dhe **tek** janë dy forma të së njëjtës parafjalë. Forma **te** përdoret para një emri a përemri që nis me bashkëtingëllore, kurse forma **tek** përdoret para një emri a përemri që nis me zanore. (Beci,2002,f.89) .

P.sh.Ne u morëm vesh që të takoheshim te shkolla.

P.sh.Ne u morëm vesh që të takoheshim tek unë.

Lidhëzat në gramatikën për klasat e gjashta janë paraqitur në dy rubrika: vështrim dhe pyetje. Është me rëndësi të thuhet se për lidhëzat nuk mjaftojnë vetëm dy rubrika sepse për nxënësit është shumë e vështirë t'i mësojnë ato vetëm me dy rubrika .Pjesa didaktike e një libri sidomos e një teksti shkollor, është shumë e rëndësishme për nxënësit sepse aty është pjesa kryesore në të cilën bazohet mësimdhënësi për shpjegimin e gramatikës.

Në këtë njësi për lidhëzat thuhet që janë fjalë të pandryshueshme të ligjëratës, e cila i lidh pjesët e një fjalisë ose dy fjali mes vete. (Rugova, Elezi, Jakupi & Baftiu.,2019,f.92).

Aty më pas shpjegohen llojet kryesore të lidhëzave të cilat janë:

1. **Lidhëza bashkërenditëse**-shërbejnë për të lidhur pjesë të njëjta të fjalisë për fjali të një lloji.
2. **Lidhëza nënrenditëse**-shërbejnë për ta lidhur fjalinë kryesore me pjesën e varur.

Lidhëza bashkërenditëse: *as, dhe, edhe, e, a, apo, kurse, mirëpo, por, veçse, andaj, prandaj etj.*

Lidhëza nënrenditëse: *se, që, në, nëse, ku, nga, sapo, derisa, meqë, ngase, me qëllim etj.*

E shohim që vetëm me një përkufizim të shkurtër janë dhënë definicione për llojet e lidhëzave, duke mos dhënë as edhe një shembull i vetëm.

Sipas ndërtimit lidhëzat ndahen në:

a) **Lidhëza të thjeshta:** *apo, as, dhe, edhe, ose, por etj.*

b) **Lidhëza të përbëra:** *kurse, meqë, derisa etj.*

c) **Shprehje lidhëzore:** *për arsye se, me kusht që, në vend që etj.*

Drejtshkrimi i lidhëzave:

Dallohen me shkrim lidhëzat **nëse, ngase, sesa, sepse, porsa, pors**i nga përdorimet e pjesëve përbërëse të tyre si fjalë të veçanta:

Lidhëza	Fjalë të veçanta
Nëse nuk vjen më shkruaj. Nuk shkoi ngase kishte frikë. Më mirë të lexosh, sesa të rrish kot. Ai u vonua sepse i iku autobusi. Porsa ta shkruash, na lexo. Punonte pors i bletë.	Në se e mbështet ti këtë mendim? Nga se bëhet letra? Më thuaj se sa ka vlerë ky punim. As unë nuk e di se pse ai nuk erdhi. Por sa kushton kjo, askush nuk na tha. Por si e bëri, nuk na tregoi.

Si përfundim në tekstin shkollor për klasën e gjashtë sa i përket pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës janë përmendur: Ndajfolja, parafjala dhe lidhëza duke mos u përmendur fare as pasthirma as pjesëza, duke mos i informuar nxënësit jo më gjerësisht për to por as që të përmenden ato, sepse është e rëndësishme për nxënësit të dinë që t’i dallojnë ato në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare. Edhe disa shembuj që janë përmendur në gramatikën e klasës së gjashtë janë përmendur shumë pak .

Te njësia për lidhëzat kemi mungesë shumë të madhe të shembujve . Aty vetëm shpjegohen llojet e lidhëzave dhe ndarja e tyre duke mos dhënë asnjë shembull për asnjërën prej tyre, duke e bërë kështu shumë më të vështirë kuptimin e tyre.

2.4. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikën e klasës së 7

Në gramatikën e klasës së shtatë të autorëve: Rrahman Paqarizi dhe Adelina Selmani dhe me gjithsej 35 njësi, për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës janë dy njësi të njëjta që përsëriten prej klasës së gjashtë :kemi të bëjmë përsëri më ndajfoljen dhe me lidhëzat.

Duke i hedhur një vështrim përmbajtjes së librit “Gjuha shqipe 7” shumica e njësive mësimore kishin të bëjnë me teksteve joletrare, më shumë se gjysma e njësive që përmban ky tekst shkollor janë nga fusha e gazetarisë, të ndërtuara mbi stilin gazetaresk e diskursin publicistik duke mos i kushtuar rëndësi gramatikës se gjuhës shqipe ani pse ishte libër i gjuhës. Për temën tonë siç e

përmendëm më lartë ishin ndajfolja dhe lidhëza njësi këto të përsëritura që nga klasa e gjashtë. Ndoshta me një bashkëpunim më të mirë me hartues të librave të gjuhës shqipe me qenëse kemi shume se çfarë të flasim nga gramatika e gjuhës shqipe është dashur që se paku të përmenden se cilat janë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe të shpjegohen pjesë të tjera e jo ato që janë përsëritur pra ndajfolja dhe lidhëza. Në këtë tekst shumica e njësive janë dhënë vetëm si përshkrim dhe shpjegim pa pasur një ndarje në rubrika siç e patëm në librin për klasat e gjashta. Te pjesa ku shpjegohet gramatika e gjuhës shqipe gjegjësisht të ndajfolja kemi vetëm shpjegimin për ndajfoljen në pika shumë të shkurtëra.

Edhe këtu shpjegohet ashtu si në librin e klasës së gjashtë që ndajfolja e ka kategorinë e shkallës veçori kjo që e bënë të dallueshme nga pjesët e tjera të ligjëratës, por derisa aty e patëm të ilustruar me së paku nga një shembull këtu vetëm që përmendet që ndajfolja ka kategorinë e shkallës duke mos përmendur fare as edhe një shembull të vetëm.

Totalisht mungesë e aparaturës didaktike të “Gjuha shqipe 7”. Përderisa të gramatika e klasës së 6 patëm një ndarje në rubrika dhe se paku disa pyetje për nxënës as aty të mjaftueshme por këtu kjo pjesë mungon fare. Kemi vetëm një përkufizim të shkurtër me një tekst fare të shkurtër: **“Vrapova shpejt dhe u lodha shumë pasi caku ishte larg por prapëseprapë drita arriti më shpejt. Unë u vonova për shkakun se atletet e reja më shtrëngonin më fort.”** Me të zeza janë nënvizuar ndajfoljet dhe më pas i tërë teksti është me klasifikim të ndajfoljeve duke mos pasur mundësi nxënësit të kenë asnjë angazhim në lidhje me mësimin për ndajfoljen.

E njëjta ndodh edhe me njësinë për lidhëzat e cila vjen vetëm me një përkufizim dhe me ndarjen kryesore të lidhëzave duke mos dhënë asnjë sqarim tjetër asnjë detyrë dhe asnjë shembull për të kuptuar më mirë njësinë për lidhëzën dhe llojet e saj. Jo që nuk jepet shpjegim për të por nuk ka as edhe një shembull fjali me lidhëzat në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi që t’i dallojnë ato në ndonjë

tekst. Është pothuajse shpjegim i njëjtë edhe për ndajfoljen me shembuj të ndryshëm, përpos që këtu përmendet klasifikimi i ndajfoljeve sipas funksionit që kryejnë ato në fjali: në ndajfolje përcaktore dhe rrethore.

Më pas ndajfoljet përcaktore që ndahen në **ndajfolje të mënyrës** dhe **të sasisë**. Kjo është e vetmja pjesë për ndajfoljen që është më e zgjeruar sepse për pjesë të tjera nuk flitet fare:

Më pas aty tregohet që:

1. Ndajfoljet e mënyrës ndahen në ndajfolje që për nga ana kuptimore janë të ndryshme, dhe përmenden disa sosh siç janë:

- a) Ndajfoljet që përcaktojnë ecurinë e procesit të veprimit. Psh: Hante **ngadalë** duke fshirë herë pas here buzët e holla.
- b) Ndajfolje që tregojnë përmasa: **cekët, gjerë, gjatë, ulët** etj. Psh: Kujdes i madh duhej të tregohej në mbjellje, se, po u lodh fara **thellë a cekët**, e mori lumi.
- c) Ndajfolje të formuara me prapashtesën **(i) sht: djallëzisht, artistikisht, trimërisht, imtësisht, zyrtarisht** etj. Psh. Skëndërbeu ishte informuar **hollësisht** për numrin dhe cilësinë e ushtrisë turke.

2. Ndajfoljet e sasisë: shprehin intensitetin e shkallës së veprimit: **fort, fort e më fort, një herë, dy herë, një fish, dy fish** etj. Psh: Bir, dëgjomë mua, se kam jetuar **tri herë më shumë** se ti.

Vlen të përmendet që këtu janë paraqitur me një pjesë të madhe të hijezuar duke treguar që si ndajfolje mënyre meren edhe fjalët e tipit: **rusisht, anglisht, gjermanisht, bullgarisht**, dmth fjalët që tregojnë së në ç' gjuhë flet një popull.

Është edhe një rubrikë e veçantë dhe e vetmja “**Mos harro**” duke nënvizuar gjërat themelore për ndajfoljen në pika shumë të shkurtëra që do jepen në vazhdim:

-Ndajfolja na tregon më shumë për foljen.

-Ndajfolja e përshkruan dhe e ndryshon deri diku foljen.

-Ndajfolja tregon mënyrën se si është kryer veprimi, tregon sasinë, vendin, kohën e ndonjëherë edhe shkakun.

Në librin për klasën e shtatë si pjesë të pandryshueshme të ligjëratës janë të paraqitura edhe lidhëzat në vetëm një faqe të vetme duke mos u ndarë në asnjë rubrikë që është shumë e vështirë si për mësimdhënësit në shpjegimin e tyre ashtu edhe për nxënësit në kuptimin më të gjerë të tyre pasi aty vetëm është treguar se cilat është ndarja e lidhëzave me anë të tabelave edhe llojet tyre. Do ti paraqesim ashtu siç janë dhënë në tekst për arsye që të shohim se si janë shpjeguar aty me një përkufizim shumë të shkurtër dhe pa asnjë shembull të dhënë për asnjërën prej tyre:

Lidhëza bashkërenditëse –shprehin raporte barazie, shërbejnë për të lidhur dy gjymtyrë të dy fjalive të një fare (të dyja të pavarura, të varura a kryesore) (Paqarizi&Selmani,2019,f.81).

Këpujore	Veçuese	Kundërshtore	Përmbyllëse	Shkallëzimit
as, edhe, dhe, si hem. hem, si. si si..edhe	a, apo, ose daç.. daç, Ja..ja, qoftë...qoftë	kurse, megjithatë, megjithkëtë, mirëpo ndërsa, teksa ,porse, veç, veç që, vetëm, vetëm se.	andaj, ndaj prandaj, pa.	jo që..po, jo veç që...por edhe, je që ..por as, le që .. por edhe

Lidhëza nënrenditëse-shprehin raporte varësie, kryesisht për të lidhur një fjali të varur me fjalinë drejtuese të saj.

Ftilluese	Vendore	Kohore	shkakore	qëllimore	krahasore-mënyrore	Kushtore	rrjedhimore	lejore	Kundërvënëse
Se,që,në nëse	Ku,tek,n ga,kudo, ngado	kur,sa derisa, gjersa, mbasi	se,sepse si,meqë nga	që,me qëllim që në mënyrë që	sa,si,se, sesa.porsi sikurse ashtu siç	në,po, nëse, sikur	Sa,saqë, që,aq, kështu që	edhe në,nd onëse	nëse në vend që

Shohim pra se si është bërë ndarja e lidhëzave me vetëm nga një tabelë të vetme duke mos i kushtuar rëndësi fare që të ilustrohen së paku me nga një shembull.

Përderisa në librin e klasës së gjashtë janë paraqitur në mënyrë më të zgjeruar duke i kushtuar lidhëzave një pjesë dukshëm më të madhe duke u ndalur si në drejtshkrimin e tyre ashtu si dhe në ndarjet e tjera që lidhëza ka , këtu kemi vetëm ndarjet kryesore pa as edhe një shembull të vetëm dhe pa asnjë rubrikë tjetër te pjesa didaktike në mënyrë që t’u mundësojë nxënësve kuptimin dhe qasjen sa më të lehtë.

2.5. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikën e klasës së 8

Libri i gjuhës shqipe për klasën e tetë me autor Bahri Becin, është i ndarë në katër kapituj, me gjithsej 41 mësim ose seanca mësimore. Çdo mësim kushtuar problemeve të sistemit gjuhësor ka katër rubrika: të vëzhgojmë, të pyesim, të mësojmë dhe të ushtrohemi.

Në këtë tekst në lidhje me temën tonë, pra për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës kemi të bëjmë me pjesëzat dhe pasthirmat, pra këto të përmendura për herë të parë sepse këto nuk përmenden as në klasën e gjashtë dhe as në klasën e shtatë, pra për nxënësit janë njësi të reja mësimore. Përderisa në gramatikën “Gjuha shqipe 7” nuk patëm fare ndarje dhe as aparaturë didaktike të “Gjuha shqipe 8” e kemi një ndarje tjetër pak më të gjerë. Në rubrika të ndara : vështrim, pyetje, mësim dhe ushtrim kemi pak më shumë mundësi për kuptim më të mirë të kuptimit të pasthirmave pasi kjo është edhe njësi e re që shpjegohet .

Këtu u jepet me shumë mundësi nxënësve për detyra dhe aktivizim nga ana e tij mirëpo as këtu në mënyrë të kënaqshme. Që në fillim të faqes së librit kemi qëllimin e njësisë mësimore që është të njihen dhe të përdoren drejt pjesëzat . Nxënësit kanë mundësi që përmes rubrikës “Vështrojmë” të lexojnë një tekst shumë të shkurtër me titullin “Rrëfimi i njeriut me samar” ku me shkronja të kuqe janë nënvizuar se cilat janë pjesëzat në tekst.

Në rubrikën tjetër ”Mësojmë” që është pjesa më e rëndësishme e tekstit për arsye që aty duhet të jepen shpjegime për pjesëzat, aty edhe pse është njësi e re aty janë shpjeguar në pika shumë të shkurtëra llojet dhe ndarjet e pjesëzave. Pasi që për nxënësit kjo është njësi e re mësimore është dashur që t’i kushtohet më shumë rëndësi njësisë mësimore që nuk janë paraqitur me parë sepse edhe kurioziteti i nxënësve është më i madh ,andaj edhe pjesa didaktike duhet të ishte me informacione dhe me rubrika sa më të shumta në mënyrë që nxënësit të kenë më të lehtë si në kuptimin e tyre ashtu edhe në detyrat që caktohen në lidhje me pjesëzat. Aty janë shpjeguar llojet dhe ndarja e pjesëzave në pika shumë të shkurtëra, duke u përmendur vetëm llojet dhe disa prej pjesëzave, pa as edhe një shembull të vetëm. Pjesëzat mund të jenë fjalë të thjeshta, të përngjitura ose lokucione:

- a) **të thjeshta:** bile, ja, nuk etj
- b) **të përngjitura:** posi, thuajse, kushedi etj
- c) **lokucione:** as që, ja që, po se po etj (*Beci,2004,f.100*).

Sipas kuptimit pjesëzat ndahen ne tri grupe kryesore:

- a) pjesëza që shprehin nuanca kuptimore
- b) pjesëza modale
- c) pjesëza emocionale.(Beci,2004,f.100).

Në një rubrikë tjetër “Kujdes” aty shkruhet “**Shumë nga pjesëzat e mësipërme përdoren edhe si përemra**(ç, sa, që), **si ndajfolje** (gati, vetëm, rreth, plot), **si parafjalë si emra** (rreth), si parafjalë (pa), **si lidhëza** (porsa, që, vetëm, edhe, (dhe) a, e, as) **dhe si pasthirrma** (o,e,a)”. (Beci,2004,f.101). Këtu duke mos u dhënë asnjë shpjegim tjetër përfundon pjesa e shpjegimit duke vazhduar më pas me rubrikën “Ushtrohemi” . Në këtë rubrikë janë të paraqitura gjithsej 3 detyra , të cilat janë të njëjta: është dhënë një tekst letrar për të trija detyrat dhe në atë të nënvizojnë parafjalët që gjenden në atë tekst. Për nxënësit e klasave të teta është me rëndësi që të kuptojnë me thelb parafjalën, dhe ndoshta në një ushtrim është dashur që të u jepet mundësia atyre të zgjedhin një tekst sipas dëshirës dhe t’i dallojnë parafjalët në atë tekst në mënyrë që të mund të angazhohen më shumë edhe në leximin e titujve të ndryshëm letrar.

Menjëherë pas njësisë për parafjalëve vjen njësia për pasthirmën.

Te rubrika “Mësojmë” kemi vetën një përkufizim për pasthirmën: “Pasthirmat janë tinguj ose fjalë të pandryshueshme, që shërbejnë për të treguar ndjenjat e folësit ose përdoren për të tërhequr vëmendjen e folësit” (Beci,2004,f.105). Më pas shpjegohen se cilat janë llojet e pasthirmave të cilat ndahen në të parme dhe jo të parme por pa dhënë as edhe një shembull të vetëm për asnjërën nga llojet që përmenden në këtë libër.

Gjithashtu shpjegohet që sipas kuptimit ato ndahen në dy grupe të mëdha:

Pasthirma emocionale që shprehin ndjenja dhe pasthirma urdhërore që shprehin dëshirën dhe vullnetin e folësit. Janë dhënë edhe llojet për secilën prej tyre por aty janë përmendur vetëm si lloje dhe pa asnjë ilustrim shembulli mbyllet kapitulli për mësimin dhe shpjegimin e pasthirmave. Edhe detyrat për njësitë që shpjegohen aty janë të njëjta si te njësia për pasthirmat ashtu edhe te njësia për pjesëzat.

Është marrë i njëjti tekst i shkëputur nga pjesë libri të Mark Tuenit dhe është kërkuar detyra e njëjtë që të nënvizojnë te njëra pjesëzat te tjetra pasthirmat. Duhet të theksohet edhe pjesa që përveç se në gramatikën e klasës së 6 që ishte vetëm një tekst letrar, në gramatikën e klasës së 8 te pjesa ku shpjegohet pasthirma e gjejmë edhe aty një poezi të Gjergj Fishtës me titull “LAMTUMIRË”. Në asnjë njësi tjetër nuk kemi një ndërlidhje të teksteve letrare me gjuhën dhe me shpjegimin e tyre në mënyrë sa me të qartë.

E shohim këtu një varfëri të madhe si të përkufizimeve si të shembujve si të detyrave për një arritje të kënaqshme të njohurive për pjesë të ligjëratës e në rastin tonë për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

2.6. Didaktika e gjuhës shqipe

Mund të themi se ende nuk po i jepet rëndësia e veçantë didaktikës së mësimdhënies së gjuhës shqipe. Tradicionalisht, po edhe në ditët e sotme, përparësi i është dhënë e vazhdon t’i jepet përgatitjes së mësuesit si mësimdhënës, aftësimit të tij për t’iu përgjigjur lëndës dhe klasës ku jep mësim, për të përçuar te nxënësit materialin mësimor. Një praktikë e tillë, jo qëllimisht, ka lënë në harresë nxënësin, të nxënësve prej tij.

Duke e parë mësimdhënien në shërbim e në funksion të të nxënësve, ka ardhur koha, për të mos thënë se jemi vonuar, që të investohet me më shumë përparësi te nxënësit. Çfarë kuptojmë me investim te nxënësit? Të investosh te nxënësit do të thotë të ndikosh tek ata për të rritur shkallën e përgjegjshmërisë së tyre për vlerësimin e vetvetes. Një proverb i vjetër thotë: “Atë që dëgjoj, e harroj. Atë që shikoj, e mbaj mend. Atë që them dhe e bëj, e kuptoj”. Përfshirja e nxënësve në veprimtari për të folur e për të bërë, i bën ata aktivë, i nxit të mendojnë vazhdimisht për të vepruar, për të eksploruar ide e koncepte, për t’u përfshirë në debat e dialog, për të diskutuar e për të marrë vendime, për të bashkëvepruar, për të nxënë.

Në Kosovë, mësimi i gjuhës shqipe në shkollë, si lëndë kryesore dhe me fondin me të madh të orëve, ka për qëllim të krijojë dhe ndërtojë vetëdijen për rëndësinë e gjuhës dhe përvetësimin e saj të përshkallëzuar. Në këtë funksion është konceptuar dhe programi i lëndës për klasët përkatëse: “Sikurse programi i klasëve paraprake edhe programi i klasëve 6-8, është organizuar në kuadër të këtyre kategorive si: të dëgjuarit dhe të folurit; të shkruarit; të lexuarit dhe të

nënkategorive si: kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturë e të lexuarit dhe kulturë e të shkruarit; tekste letrare dhe joletrare si dhe njohurive gjuhësore.”. (- Mësimdhënia e gjuhës shqipe në një vështrim bashkëkohor – Tiranë, nga prof. dr Besnik Rama)

2.7. Metodologjia e gjuhës shqipe

Zhvillimet e sotme të teknologjive të reja lejojnë të përdoren në procesin mësimor teknologji, të tilla si: video, kompjuter, internet, telefonë të mençur etj. Sot në të gjitha shkollat tona ka shkuar interneti dhe nuk ka shkollë pa kabinetin e informatikës. Ndërkohë, edhe vetë nxënësit, duke shfrytëzuar TIK-un, janë bërë burim i gjetjes dhe i sjelljes në orët e mësimit të materialeve autentike të nxjerra nga masmedia. Nxënës të veçantë arrijnë të realizojnë dhe punë me projekte përmes sigurimit të informacionit nga interneti. Ecuria dhe mbarëvajtja e orës së mësimit në gjuhë shqipe dhe letërsi janë të kushtëzuara nga zgjedhja dhe zbatimi i një metode sa më të efektshme, i një metode që merr parasysh dhe mbështetet në natyrën dhe vëllimin e informacionit të ri, në kushtet reale të klasës dhe në formimin gjuhësor e letrar të çdo nxënësi. Bashkëbisedimi është një metodë që mund të praktikohet në një pjesë të mirë të etapave të orës së mësimit: në fillim të orës, gjatë paraqitjes së njohurive të reja, gjatë praktikës së drejtuar, gjatë punës në grup, gjatë përpunimit të informacionit, gjatë kontrollit formues dhe kontrollit të praktikës së pavarur etj. Mësuesi duhet të mbështetet në përvojën vetjake të nxënësve, pa u trembur se ata nuk zotërojnë njohuri të plota për çështjet e konceptet që trajtohen në orën e mësimit. Për të pasur efektivitet në bashkëbisedim, mësuesi i nxit nxënësit që ata të bëjnë vëzhgime gjuhësore, të lexojnë e të nënvizojnë për të veçuar, për të analizuar, për të krahasuar etj. Forma të tilla aktivizimi të nxënësve rrisin vlerat e bashkëbisedimit mësues-nxënës dhe nxënës-nxënës, duke e ngritur bashkëbisedimin në nivelin e diskutimit mësimor, sepse nxënësit, për problemet që trajtohen, gjejnë e japin argumente për të mbrojtur secili zgjidhjet e veta. Pa pretenduar dhënie recetash, mendojmë se, në themel të gjithë procesit mësimor, përparësia u takon metodave ndërvepruese, pasi këto metoda ndikojnë zhvillimin e shprehive ndërpersonale të nxënësve, e bëjnë mësimin më tërheqës, sigurojnë gjithëpërfshirje, zhvillojnë shprehitë bashkëpunuese ndërmjet vetë nxënësve dhe ndërmjet nxënësve e mësuesit etj. Pra, duke zbatuar këto metoda: Metoda që nxisin zhvillimin e meditimit kritik Metoda ndërvepruese mësimdhënieje Mësimdhënie me nxënësin në qendër. Sot kemi në dorë një literaturë mjaft të gjerë të pasur, që

ka të bëjë me metodologjinë, e didaktikën. Gjithë kjo literaturë (megjithëse vazhdon të ketë prirjet për të na sjellë përvojën bashkëkohore të botës), ka futur praktika të reja në të dhënët mësim nga mësuesi dhe të nxënës nga nxënësi. Mendojmë se sot në shkollën tonë vërehen tri stile mësimdhënieje:

1. Me metodat tradicionale 2. Me të mësuarit me objektiva 3. Me teknika të ERR-së.

Besoj që kjo formë e të punuarit dhe këto metoda do të sjellin ndryshime pozitive dhe do të japin rezultate më të larta te nxënësit tanë nëpër shkollat tona dhe do t'u lehtësohet mësimnxënia. (Mësimdhënia e gjuhës shqipe me një vështrim bashkëkohor-Tiranë, nga prof. dr Besnik Rama)

III. KAPITULLI I TRETË

3. Formulimi i problemit

Arsimimi në shkolla është një çështje shumë e ndërlikuar pasi që për fëmijë shkolla është institucioni kryesor që ata marrin njohuritë e tyre që nga fillimi i rrugëtimit të tyre të dijes. Tekstet shkollore që u japin atyre, janë informacioni themelor që ata marrin dhe që i përcjellë gjatë të gjitha viteve të shkollimit, andaj tekstet shkollore që u ofrohen nxënësve duhet të jenë me informacione sa më të sakta dhe sa më të kuptueshme për nxënësit. Siç e dimë, arsimi vijon të paraqes disa probleme siç janë: literatura, mospërshtatja e literaturës, mungesë e shembujve, përsëritje e temave ose përmbajtjes së teksteve, literaturë të vjetruar dhe joadekuate. Në disa raste ka edhe mungesë të literaturës për këtë nivel shkollimi dhe nxënësit janë të obliguar të mësojnë nga literatura ekzistuese. Është shumë e rëndësishme që të bëhet furnizimi i nxënësve me literaturë të re dhe me autorë të ndryshëm.

Duke pasur objekt studimi trajtimin e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në gramatika për shkollën e mesme të ulët (6-8), tema që e kam zgjedhur për këtë punim, mendoj se duhet trajtuar dhe të shihet në mënyrë më të detajuar.

3.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të evidentojë përfshirjen e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në gramatikat ekzistuese që përdoren në shkollat e mesme të ulëta.

Qëllimi që shtrohet përpara këtij hulumtimi mund të përkufizohet edhe si qëllim i një rëndësie të veçantë dhe kjo, pikërisht, për faktin se formimi i fëmijëve në aspektin gjuhësor dhe literatura më të cilën ata janë në kontakt, pothuajse çdo ditë, luan një rol jashtëzakonisht të veçantë.

3.2.Rëndësia e studimit

Ky studim është i rëndësishëm edhe për shkak të synimit që në esencë ka, të studiojë problemin e gramatikave me të cilët mësohen dhe zhvillohen fëmijët tanë në aspektin gjuhësor. Duhet të rikujtojmë se gjatë dekadës së fundit janë bërë disa ndryshime në arsim në Kosovë dhe kjo sigurisht ka ndikuar dhe në ndryshimin e literaturës. Kjo dukuri është gjithnjë në rritje, por ka mbetur pa u hulumtuar shumë dhe ka kaluar disi në heshtje dhe sfidat që e përcjellin këtë proces janë të mëdha dhe ne po e trajtojmë vetëm aspektin që ka për qëllim punimi ynë. Pra a janë përfshirë mjaftueshëm pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikat që përdorin klasat e shkollës se mesme të ulëta.

3.3 Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza

Pyetjet e hulumtimit kanë një rëndësi thelbësore për projektin dhe i japin punimit kahjen e shqyrtimeve. Pyetjet e hulumtimit kanë funksion të dyfishtë: në njërin anë shpreh qëllimin e punimit dhe në anën tjetër na ndihmon në procesin e hulumtimit.

1.Cilat pjesë të pandryshueshme të ligjëratës janë përfshirë në tekstet shkollore për nxënësit e klasave 6,7 dhe 8 ?

2.A janë paraqitur mjaftueshëm pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në tekste shkollore?

3. A ka mjaftueshëm shembuj të dhënë për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës ?

Hipotezat e ngritura:

1. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës nuk janë paraqitur në masë të mjaftueshme në gramatikat 6, 7 dhe 8.

2.Në tekstet shkollore te klasave 6,7 dhe 8 mungojnë në masë të madhe shembujt mbi pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

3.4 Metoda e hulumtimit, popullacioni dhe kampioni

Për të realizuar një punim hulumtues shkencor të arrirë, duhet të sigurohemi që të përdorim një literaturë të bollshme teorike. Burim kryesor të të dhënave do të konsiderojmë gramatikat e klasave 6-8, të shkollës së mesme të ulët, nga të cilat do të vjelim informacione të konsiderueshme, për të parë se sa janë paraqitur pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, si janë klasifikuar dhe sa janë të kuptueshme ato për nxënës të klasave 6-8 duke u përshtatur moshës së tyre.

Sigurisht nuk do të lëmë pa shfrytëzuar edhe literaturë shkencore nga gjuhëtarë vendas të cilët kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me këtë çështje, të cilën po përpiqemi të trajtojmë në këtë hulumtim. Këto dhe burime të tjera të informacionit do t'i paraqesim në pjesën e referencave bibliografike.

Sa i përket metodologjisë së mbledhjes së materialit dhe punës tonë, kemi përdorur këto metoda:

Metoda e analizës së dokumentacionit - e cila fillon me grumbullimin e dokumentacionit (punimet monografike, librat, tekstet mësimore, gazetatat etj.) mbi të dhënat dhe rezultatet tashmë ekzistuese, që kanë të bëjnë me problemin e hulumtimit.

Metoda përshkruese Kjo metodë mundëson përshkrimin analitik të dukurive të ndryshme, ashtu siç janë, paraqiten dhe zhvillohen në realitet. Përshkrimi duhet të zbulojë shkaqet dhe pasojat e dukurive, në mënyrë që në bazë të rezultateve të nxirren konkluzione, fakte, teori etj.

Metoda krahasuese (komparative)- përdoret për konstatimin e ngjashmërisë dhe ndryshimit në mes të dukurive të ndryshme, në këtë rast do të bëjmë krahasimin e pjesëve të pandryshuara të ligjëratës nëpër klasa të ndryshme.

3.5.Populacioni

Për popullatë janë marrë nxënësit dhe mësimdhënësit e lëndës së gjuhës shqipe të shkollave të mesme të ulëta të komunës së Mitrovicës. Për zgjedhjen e kampionit janë marrë katër shkolla me nga një paralele për nxënës të klasëve 6,7 dhe 8. Nga klasa e 6 kemi gjithsej 87 nxënës, nga klasa e 7-të kemi 90 nxënës dhe nga klasa e 8-të kemi 97 nxënës me gjithsej 274 nxënës nga katër shkollat dhe 20 arsimtarë të po atyre shkollave. Shkollat e mesme të ulëta që janë përfshirë në këtë punim janë: ‘‘Andon Zako Çajupi’’, ‘‘ Migjeni’’, ‘‘Abdullah Shabani’’ dhe ‘‘Ismail Qemali’’.

3.6 .Pyetësorët

Për realizimin e këtij hulumtimi, më konkretisht për mbledhjen e të dhënave janë përdorë dy pyetësorë me pyetje me përgjigje alternative, kryesisht për përfshirjen e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në librat e gramatikës për klasat 6-8. Pyetësori i parë është për mësimdhënësit e gjuhës shqipe të shkollave të mesme të ulëta me 20 arsimtarë siç e cekëm më lartë, kurse pyetësori i dytë është për nxënësit e klasave 6,7 dhe të 8-ta me gjithsej 274 nxënës të po atyre shkollave. Pyetësori është përdorë për të arritur rezultate sa më të sakta për temën që e kemi realizuar.

3.7 Etika e hulumtimit

Për realizimit e këtij hulumtimi, gjegjësisht pyetësorëve është respektuar anonimiteti i të dhënave të nxënësve dhe arsimtarëve, me qëllim të realizimit sa më të saktë. Janë përfshirë të dyja gjinitë për nxënës dhe të dyja gjinitë për mësimdhënësit të moshave të ndryshme .

3.8.Analiza

Të dhënat e marrura në terren janë vendosur në programin për analizën e të dhënave statistikore SPSS 21 (Paketës Statistikore për Shkencat Shoqërore), ku me anë të këtij programi është bërë analiza e të dhënave dhe paraqitja e të dhënave është bërë përmes përqindjes, mënyrës tabelare dhe grafike.

3.9.Rezultatet e pritura

Nga ky hulumtim pritet që të nxirren rezultate të shumta. Do të shohim se çfarë mendojnë mësuesit dhe nxënësit në lidhje me përfshirjen e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në librat e gramatikës, a mendojnë ata që duhet të ndryshojë diçka në librat që ata i mësojnë çdo ditë në shkollë dhe se a ka përkufizime dhe shembuj të mjaftueshëm në tekste shkollore që jepen për ta.

IV. ANALIZA E REZULTATEVE

4.1 Analiza e rezultateve për pyetësorët e realizuar me mësimdhënës

Të dhënat sasiore nga pyetësorët do të interpretohen në tabela dhe diagrame

Tabela 1. Paraqitja e përgjigjeve në formë tabelare sipas pyetjeve të pyetësorit për mësimdhënës

Pyetja	Zgjidhje A	Zgjidhje B	Zgjidhje C	Zgjidhje D	Zgjidhje E	Totali
Pyetja 1	9	8	3	-		20
Pyetja 2	11	-	9	-		20
Pyetja 3	9	5	6	-		20
Pyetja 4	10	5	5	-		20
Pyetja 5	4	6	10			20
Pyetja 6	9	6	5			20
Pyetja 7	2	3	4	11		20
Pyetja 8		6	4	5	5	20
Pyetja 9		9	11			20
Pyetja 10	11	4	2	3		20

Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas shkollave në hulumtimin e kryer me mësimdhënës


Shkolla e pjesëmarrësve	Pjesëmarrësit	Përqindja
Abdullah Shabani	6	30%
Migjeni	5	25%
Ismail Qemali	5	25%
Andon Zako Cajupi	4	20%
Totali	20	100%

Tabela 3. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë në hulumtimin e kryer me mësimdhënës

Gjinia	Pjesëmarrësit	Përqindja
Femer	11	55%
Mashkull	9	45%
Total	20	100%


Me anë të diagrameve do të paraqesim përqindjet e përgjigjeve të mësimdhënësve për secilën pyetje.

Pyetja1. Sa janë të përfshira pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatika për klasën e 6, 7 dhe 8?




Grafikoni 1. Në pyetjen e parë rreth përfshirjes së pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në gramatika shohim që 45% e të anketuarve u përgjigjën në opsionin aspak dhe 40% të tjerë në opsionin pak dhe 15% deri diku.

Pyetja 2. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës më shumë përfshihen:




Grafikoni 2. Në pyetjen e dytë se në cilat klasa mendoni se janë përfshirë më shumë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës 55% u përgjigjën në klasën e gjashtë, dhe 45% të tjerë në klasën e tetë ndërsa për klasën e shtatë nuk pati asnjë.

Pyetja 3. Librat e gramatikës që përdoren në klasat 6,7 dhe 8 a janë të përshtatshme për nxënës?




Grafikoni 3. Në pyetjen e tretë në lidhje me librat e gramatikës që përdoren për klasat 6,7 dhe 8 se sa janë të përshtatshme për nxënës, 45% u përgjigjën në opsionin aspak, 25% pak dhe 30% deri diku.

Pyetja 4. Përkufizimet, shembujt për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës a janë përfshirë mjaftueshëm në gramatika të gjuhës shqipe?




Grafikoni 4. Në pyetjen e katërt se përkufizimet dhe shembujt për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës janë përfshirë mjaftueshëm në gramatika , 50% u përgjigjën aspak, 25% pak për të vazhduar me 25% deri diku.

Pyetja 5. A mendoni që mësimi për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës i përshtatet nivelit të nxënësve?




Grafikoni 5. Në pyetjen e pestë në lidhje me përshtatshmërinë e nivelit të nxënësve në lidhje me mësimin e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, 50% u përgjigjën deri diku, 30% pak, 20% aspak.

Pyetja 6. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikat 6,7 dhe 8-të a përshtatet për mësim të pavarur nga nxënësit?




Grafikoni 6. Në pyetjen e gjashtë se a përshtatet mësimi për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës për mësim të pavarur nga nxënësit, 45% dhanë opsionin aspak, 30% pak dhe 25% deri diku.

Pyetja 7. A kanë vështirësi nxënësit gjatë përdorimit të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës gjatë detyrave në klasë?




Grafikoni 7. Në pyetjen e shtatë se a kanë vështirësi nxënësit gjatë detyrave në klasë 55% u përgjigjën në opsionin shumë ,ndërsa në opsionet tjera të dhëna 20% në opsionin deri diku,15% pak dhe 10% aspak.

Pyetja 8. Nxënësit kanë vështirësi të dallojnë:




Grafikoni 8. Në pyetjen e tetë kemi bërë pyetjen se cilat pjesë të ligjëratës nxënësit e kanë më vështirë që t'i kuptojnë,32% u përgjigjën lidhëzën dhe 26% pjesëzën dhe nga 21% ishin parafjala dhe pasthirma

Pyetja 9. A u jepni nxënësve informacione shtesë në lidhje me njësinë mësimore që e zhvilloni ?



Grafikoni 9. Në lidhje me informacionet shtesë që jepen në rastin e shpjegimit të njësive mësimore 55% u përgjigjën në opsionin po dhe 45% në opsionin ndonjëherë.

Pyetja 10. Rrumbullakëso njëren nga teknikat mësimore që përdor më shumë gjatë shpjegimit të njësive mësimore?



Grafikoni 10. Në pyetjen për teknikat mësimore që përdorin më shumë gjatë shpjegimit të njësive mësimore, 55% u përgjigjën në opsionin di, dua të di, mësova, 20% në opsionin Drta 15% në opsionin të tjera dhe 10% në opsionin Insert.

4.2 Analiza e rezultateve për pyetësorët e realizuar me nxënës

Rezultatet e pyetësorëve të realizuar me nxënës të klasave të gjashta, shtata dhe të teta në katër shkolla të qytetit.

Tabela 4. Paraqitja e përgjigjeve në formë tabelare sipas pyetjeve të pyetësorit për nxënës

Zgjidhje	Klasa 6				Klasa 7				Klasa 8			
	A	B	C	D	A	B	C	D	A	B	C	D
Pyetja 1	15	31	41	-	6	31	53		6	34	57	
Pyetja 2	41	25	21	-	4	25	61		4	27	66	
Pyetja 3	28	43	16	-	38	43	9		41	47	9	
Pyetja 4	48	30	9	-	58	31	1		65	31	1	
Pyetja 5	20	26	41	-	20	26	44		21	29	47	
Pyetja 6	19	33	35	-	19	33	38		26	33	38	
Pyetja 7	36	35	16	-	36	38	16		39	39	19	
Pyetja 8	41	34	12	-	44	34	12		44	34	19	
Pyetja 9	14	35	38	-	14	38	38		14	38	45	
Pyetja 10	40	19	16	12	43	38	7	2	50	24	3	20

Tabela 5. Shpërndarja e mostrës sipas shkollave në hulumtimin e kryer me nxënës


	Klasa 6		Klasa 7		Klasa 8		
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	
A.Shabani	22	25.3%	24	26.7%	25	25.8%	
I.Qemali	21	24.1%	21	23.3%	25	25.8%	
Migjeni	21	24.1%	22	24.4%	23	23.7%	
A.Z.Cajupi	23	26.4%	23	25.6%	24	24.7%	
Totali	87	100%	90	100%	97	100%	274

Tabela 6. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë në hulumtimin e kryer me nxënës

Gjinia	Klasa VI		Klasa VII		Klasa VIII	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Femër	40	44.4%	48	53.3	46	47.4%
Mashkull	47	55.6%	42	46.7	51	52.6%
Totali	87	100%	90	100%	97	100%


Me anë të diagrameve do të paraqesim përqindjet e përgjigjeve të nxënësve për secilën pyetje.

Pyetja 1. A e dini se cilat janë pjesët e ligjëratis?




Diagrami 1. Në pyetjen e parë të dedikuar për nxënës se a e dinë se cilat janë pjesët e ligjëratis këtu i kemi përqindjet nga përgjigjet e nxënësve me një diferencë për pyetjen e parë të klasave gjashtë me 16% tek opsioni jo, ndërsa tek opsionet e tjera nuk ka edhe një diferencë të madhe sa i përket opsioneve. Me 58.8% të opsioni po për klasën e tetë, 57.6% për klasën e shtatë dhe 47.1% për klasën e gjashtë.

Pyetja 2. Po pjesët e pandryshueshme të ligjëratis?




Diagrami 2. Në pyetjen e dytë, shohim një përqindje më të lartë të përgjigjeve në opsionin jo me 12,6% të nxënësve të klasëve të gjashta në krahasim me klasën e shtatë dhe të tetë me nga 4.4% për klasën e shtatë dhe 4.1% për klasën e tetë, ndërsa për opsione tjera siç shihet në figurë nuk ka ndonjë diferencë shumë të madhe.

Pyetja 3. A keni vështirësi në kuptimin e tyre gjatë shpjegimit?




Diagrami 3. Në pyetjen e tretë në lidhje me kuptimin e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, shumica e përgjigjeve e të gjithë nxënësve si të klasëve të gjashta, shtata dhe të teta me një diferencë të vogël të përqindjes ishin në opsionin ndonjëherë, me mbi 48%. Klasa e gjashtë ishte me përqindje më të madhe në opsionin po me 18.4%, klasa e shtatë me 10%, ndërsa klasa e tetë me 9.3%.

Pyetja 4. A janë dhënë përkufizime dhe shembuj të mjaftueshëm për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës në librat që ju i mësoni?




Diagrami 4. Në pyetjen e bërë për përkufizimet dhe shembujt e dhënë në gramatika shumica e përgjigjeve ishin në opsionin jo, 67% nxënësit e klasës së tetë, 64% klasës së shtatë dhe mbi 55% të klasës së gjashtë gjë që tregon se kemi shumë mungesa që nxënësit i vërejnë. Në opsionin po klasa e shtatë dhe tetë ishin me vetëm 1%, ndërsa klasa gjashtë me 10%.

Pyetja 5. A mendoni që përmbajtjet në gramatikat ekzistuese duhet të ndryshojnë?




Diagrami 5. Në këtë pyetje pamë që pothuajse gjysma e nxënësve ishin të mendimit që përmbajtjet në gramatika duhet të ndryshojë, më përqindje më të madhe ishin përgjigjet e nxënësve të klasave të shtata me 48,9% , 48.5 për nxënësit e klasës së tetë, dhe 47.1% për nxënës të klasëve të gjashta.

Pyetja 6. A mendoni që duhet të shtohet ndonjë njësi më shumë për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës?



Diagrami 6. Në pyetjen e gjashtë se a mendojnë ata se duhet të shtohet ndonjë njësi për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës shumica e përgjigjeve ishte në opsonin po me 42.2% klasa e shtatë, 40.2% klasa e gjashtë dhe 39.2% klasa e tetë, ndërsa në opsonin disa me pak diferencë në mes klasave ,ndërsa në opsonin jo ishin 26.8% klasa e gjashtë.


Pyetja 7. A mendoni që mësimi për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës i përshtatet nivelit tuaj?



Diagrami 7. Në pyetjen se a mendojnë ata se mësimi për pjesë të pandryshueshëm i përshtatet nivelit të tyre përgjigjet e nxënësve ishin pothuajse me pak diferencë sepse duke i parë dhe analizuar gramatikat e gjuhës shqipe përgjigjet e tyre ishin të pritshme.


Pjesa më e madhe e të anketuarve të të gjitha klasave ishin në opsionin jo dhe pjesërisht me mbi 40% dhe vetëm 18.4% e klasës së gjashtë u përgjigjën në opsionin po, 17.8% e klasës së shtatë dhe 19.6% e klasës së tetë.

Pyetja 8. A mund të mësoni në mënyrë të pavarur me informacionet që gjenden në libër?




Diagrami 8. Në pyetjen e bërë se a mund të mësoni në mënyrë të pavarur me informacionet që gjenden në libër përgjigjet ishin të pritshme sepse këtu nga përgjigjet e nxënësve të klasëve të shtatë kemi 48.9% në opsionin jo gjë që e vërejtëm edhe kur analizuam gramatikën e klasës së shtatë që aty kishte shumë pak material për të mësuar. Shohim edhe përqindjet të klasëve të gjashta dhe të tetë me përqindje më të madhe në opsionin jo me 47.1% për klasa të gjashta dhe 45.4% për klasa të tetë.

Pyetja 9. A lexoni libra shtesë për të kuptuar më mirë për njësitë që lidhen me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës?



Diagrami 9. Në pyetjen e bërë se a lexoni libra shtesë në mënyrë që të iu ndihmojnë në kuptimin e njësive mësimorë, përqindja me e madhe e përgjigjeve ishte në opsonin po për të trija klasat me shumë pak diferencë, për klasën e tetë përqindja ishte më e madhe për 4% ndërsa për opsonet tjera përqindja ishte përafërsisht e njëjtë.

Pyetja 10. Rrumbullakëso njërën nga teknikat mësimore që përdor arsimtari për zhvillimin e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës si temë mësimore?



Diagrami 10. Në pyetjen sa i përket teknikave mësimore në opsonin Di, dua të di mësova, ishin shumica e përgjigjeve të të gjitha klasave duke prirë klasa e tetë me 51.5%, klasa e shtatë me 47.8 dhe klasa e gjashtë me 46%. Kemi diferencë të teknika drta me një përqindje dukshëm më të madhe të klasa e shtatë me 42.2%, edhe të insert të klasa e gjashtë kemi një diferencë më të madhe me 18.4% ndërsa të teknikat tjera diferenca me e madhe është të klasa e tetë me 20.6%

V. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Tekstet shkollore, sigurisht që kanë një rëndësi të veçantë , në këtë mes edhe teksti i gramatikës, prandaj për të nxjerrë përfundime, si dhe për të dhënë rekomandime për ndryshimin apo edhe hartimin e tyre, pasi që kemi bërë vlerësimin e teksteve aktuale, sa i përket temës në fjalë nuk është gjë e lehtë, por duke u bazuar në rezultatet e dala nga punimi hulumtues, përgjigjet e mësimdhënësve si dhe literatura e shfrytëzuar kemi nxjerrë përfundime dhe disa rekomandime, të cilat mendojmë se janë të rëndësishme për hartimin e teksteve të reja, apo ribotimin e teksteve aktuale, sa i përket strukturës së teksteve në përgjithësi.

Hulumtimi që kemi kryer në këtë punim është fokusuar në dy anë të cilat janë të lidhura shumë ngushtë me njëra tjetrën: te mësimdhënësit dhe në atë se çfarë mendojnë ata në lidhje me përfshirjen e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në gramatikat ekzistuese që mësohen në klasat VI,VII dhe VIII ; dhe te nxënësit duke dashur që të marim përgjigje edhe nga ata rreth mendimit të tyre për përfshirjen e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në tekstet që ata mësojnë. Nga ky hulumtim pamë që shumica e mësimdhënësve nuk janë edhe shumë të kënaqur me përfshirjen e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në gramatika si dhe gjithashtu edhe pjesa didaktike lë shumë për të dëshiruar sepse pjesa didaktike është ndihmesë shumë e madhe si në lehtësimin e shpjegimit për një mësimdhënie sa më efektive ashtu edhe nxënësve në mësimnxënien sa më të suksesshme dhe sa më produktive .Janë edhe nxënësit ata që po e ndiejnë mungesën e pjesës didaktike në mësimxënie të pavarur për arsye se mungesa e shpjegimit të plotë i kushtëzon ata që të punojnë në mënyrë të pavarur e të suksesshme.

Hulumtimi vë në pah mungesën e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në gramatikat VI, VII dhe VIII si dhe rëndësinë në formimin e kulturës gjuhësore te nxënësit, gjatë procesit mësimor.

Të dhënat nga shqyrtimi i literaturës tregojnë se pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatika VI,VII dhe VIII nuk përfshihen edhe në masë të madhe.

Nga hulumtimi pamë që gjysma e mësimitdhënësve mendojnë që pjesët e pandryshueshme të ligjëratës më shumë janë përfshirë në gramatikën e klasës së gjashtë dhe disa të tjerë menduan që ato janë përfshirë në klasën e tetë ndërsa sipas pritshmërive në bazë të analizës së gramatikave pamë që te klasa e shtatë nuk kishe asnjë përgjigje.

Gjithashtu rezultatet që na kanë dhënë nxënësit dhe arsimtarët na treguan që jo çdoherë mund të mësohet nga nxënësi në mënyrë të pavarur për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës. Gjithashtu, rezultatet paraqesin dhe vërtetojnë edhe hipotezat tona se pjesët e pandryshueshme të ligjëratës nuk janë paraqitur në mënyrë të mjaftueshme në gramatika dhe sidomos shembujt që janë aty janë shumë të paktë dhe të pamjaftueshëm për një mësimitdhënie dhe mësimitxënie efikase. Gjithashtu gjatë hulumtimit pamë që mësimitdhënësit përdorin metoda dhe teknika të ndryshme për të arritur synimet e tyre për njësinë mësimore, në rastin tonë *për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës*.

Nga të dhënat gjatë hulumtimit, sa i përket teknikave të mësimitdhënies u vërtetua se teknika *Di, Dua të di, Mësova* është njëra nga teknikat më të parapëlqyera e përdorura nga mësimitdhënësit.

Në këtë mënyrë në bazë të rezultateve të arritura nga ky hulumtim rekomandimet e mia janë :

- Të ketë bashkëpunim në mes mësimitdhënësve dhe hartuesve të teksteve për hartimin e gramatikave VI-VIII.
- Të përdoren shembuj shtesë dhe detyra tjera që nuk janë dhënë në libër.
- Të punohet dhe të zhvillohet një mësimitdhënie bashkëkohore.
- Autorët e teksteve të gramatikave, të kenë parasysh përshtatjen e moshës së nxënësve me përmbajtjen mësimore.
- Të jepen përkufizime dhe shembuj të bollshëm për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës në mënyrë që të mos përsëriten të njëjtat nëpër klasa.

VI.LITERATURA

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë.(2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë.
2. Agaliu,F.,Santori,E.,Demiraj,Sh.,Dhramaj,A.,Hysa,E.,Lafe,E.,Likaj,E.(2002).*Gramatika e gjuhës shqipe* , Vëllimi 1,Tiranë.
3. Bajçinca, I. (1989). *Gjuha jonë – Gramatika e gjuhës shqipe* (Për klasën VIII të shkollës fillore). Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës autonome të Kosovës. Prishtinë.
4. Brada, R. (2011). *Pedagogjia Sociale*, Fakulteti i shkencave sociale, Prishtinë.
5. Beci, Bahri (2014), *Gjuha shqipe 6: Gramatikë- Drejtshkrim- Gjuhë e folur dhe e shkruar*, Libri shkollor, Prishtinë.
6. Beci, Bahri (2004), *Gjuha shqipe 7: Gramatikë- Drejtshkrim- Gjuhë e folur dhe e shkruar*, Dukagjini, Pejë.
7. Beci, Bahri (2005), *Gjuha shqipe 8: Gramatikë- Drejtshkrim- Gjuhë e folur dhe e shkruar*, Dukagjini, Pejë.
8. Beci, Bahri. Bubani, Loredan. Gurabardhi, Zamira (1999), *Gjuha shqipe 7: Gramatikë- Drejtshkrim- Gjuhë e folur dhe e shkruar*, Libri shkollor, Prishtinë.
9. Beci, Bahri. Bubani, Loredan. Gurabardhi, Zamira (1997), *Gjuha shqipe 8: Gramatikë- Drejtshkrim- Gjuhë e folur dhe e shkruar*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë.
10. Beci, Bahri (2002), *Gjuha shqipe 9: Për klasën e nëntë orientuese*, Libri shkollor, Prishtinë.
11. Demiraj,Sh.(1969). *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*,Rilindja,Prishtinë.
12. Eko,U.(2006).*Si shkruhet një punim diplome*.Dituria.
13. .Fjalori i shqipes së sotme (2002) Tiranë.
14. Hysa, E. (1970): *Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë.
15. Gjokutaj,M. (2012).*Didaktika e Gjuhës Shqipe*,Tiranë.
16. Memushaj,R.(2004).*Shqipja Standarde*,Toena,Tiranë.
17. Memushaj, R. (2004). *Hyrje në gjuhësi*. Tiranë: Dituria (botimi i parë 2002).
18. Paqarizi, R.,Selmani.A .(2019).*Gjuha shqipe 7*,Dukagjini,Prishtinë.

19. Rugova,B., Shpetim,E.,Jakupi, Q.,Baftiu, A.(2019). *Gjuha shqipe 6*,Dukagjini,Prishtinë.
20. Jashari, A., Çitaku, F.(2014).*Morfologjia e zbatuar*, Prishtinë.
21. Jashari,A., Kryeziu,B. (2011). *Gjuhë amtare*, Prishtinë.
22. Jashari, Ali. Kryeziu Bahtijar (2010). *Gjuhëamtare, Njohuri për gjuhën, Fonetikë, Morfologji, Sintaksë* (Për studentet e fakultetit të Edukimit), Prishtinë.
- 23..*Gramatika e gjuhës shqipe 1, Morfologjia* (2002), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.
24. Hoti, I. (2013). *Gjuhësia e zbatuar-përmes kurrikulës së gjuhës shqipe*. Shkodër.

Burime nga interneti:

<https://masht.rks-gov.net/planet-1>

SHTOJCA A

Pyetësor për mësimdhënësit

Ky pyetësor do të realizohet për hulumtimin e punimit tim të diplomës në nivelin Master. Ju lusim të jepni mendimin tuaj për pohimet e mëposhtme duke rrethuar vetëm një përgjigje që ju e konsideroni të saktë. Pyetësi respekton dhe garanton anonimitetin tuaj.

Shkolla _____

Gjinia : M / F

1.Sa janë përfshirë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatika për klasën e 6,7 dhe 8?	A) Aspak B) Pak C) Deri diku D) Shumë
2.Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës më shumë përfshihen:	A) Klasën e 6 B) Klasën e 7 C) Klasën e 8
3.Librat e gramatikës që përdoren në klasat 6,7 dhe 8 a janë të përshtatshme për nxënës?	A) Aspak B)Pak C) Deri diku D) Shumë
4.Përkufizimet,shembujt për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës a janë përfshirë mjaftueshëm në gramatika?	A) Aspak B)Pak C) Deri diku D) Shumë
5.A mendoni që mësimi për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës i përshtatet nivelit të nxënësve?	A) Aspak B)Pak C) Deri diku D) Shumë
6.Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gramatikat 6,7 dhe 8-të përshtatet për mësim të pavarur nga nxënësit?	A) Aspak B) Pak C) Deri diku D) Shumë

7. A kanë vështirësi nxënësit gjatë përdorimit të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës gjatë detyrave në klasë?	A) Aspak B) Pak C) Deri diku D) Shumë
8. Nxënësit kanë vështirësi të dallojnë :	A) Ndajfoljen B) Lidhëzën C) Parafjalën D) Psthirmen E) Pjesëzën
9. A u jepni nxënësve informacione shtesë në lidhje me njësinë mësimore që e zhvilloni ?	A) Jo B) Ndonjëherë C) Po
10. Rrumbullakëso njërën nga teknikat mësimore që përdor më shumë gjatë shpjegimit të njësive mësimore?	A) Di, Dua të di, Mësova B) Drta C) Insert D) Të tjera

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

SHTOJCA B

Pyetësor për nxënësit

Ky pyetësor do të realizohet për hulumtimin e punimit tim të diplomës në nivelin Master. Ju lusim të jepni mendimin tuaj për pohimet e mëposhtme duke rrethuar vetëm një përgjigje që ju e konsideroni të saktë. Pyetësori respekton dhe garanton anonimitetin tuaj.

Shkolla_____

Klasa

Gjinia : M / F

1.A e dini se cilat janë pjesët e ligjëratës?	A) Jo B) Disa C) Po
2.Po pjesët e pandryshueshme të ligjëratës?	A) Jo B) Disa C) Po
3. A keni vështirësi në kuptimin e tyre gjatë shpjegimit?	A) Jo B) Ndonjëherë C) Po
4. A janë dhënë përkufizime dhe shembuj të mjaftueshëm për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës në librat që ju mësoni?	A) Jo B) Pjesërisht C) Po
5. A mendoni që përmbajtjet në gramatikat ekzistuese duhet të ndryshojnë?	A) Jo B) Disa C) Po
6. A mendoni që duhet të shtohet ndonjë njësi më shumë për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës?	A) Jo B) Disa C) Po

7. A mendoni që mësimi për pjesë të pandryshueshme të ligjëratës i përshtatet nivelit tuaj?	A) Jo B) Pjesërisht C) Po
8. A mund të mësoni në mënyrë të pavarur me informacionet që gjenden në libër?	A) Jo B) Ndonjëherë C) Po
9. A lexoni libra shtesë për të kuptuar më mirë për njësitë që lidhen me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës?	A) Jo B) Ndonjëherë C) Po
10. Rrumbullakëso njërën nga teknikat mësimore që përdor arsimtari për zhvillimin e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës si temë mësimore?	A).Di, Dua të di, Mësova B) Drta C) Insert D) Të tjera

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!